Më 24 qershor të vitit 1859 një tregtar i ri nga Gjeneva rastësisht është gjetur në fushëbetejën në Solferino, Lombardi, ku janë përleshur armatat e Francës dhe Austrisë dhe kanë zhvilluar një betejë të përgjakshme me pasoja të frikshmë - 40.000 ushtarë të plagosur dhe të vdekur. Është quajtur Anri Dinan dhe ka pasur 31 vjet. Tek ai është zgjuar dëshira për humanizëm dhe së bashku me popullsinë lokale ai ka ofruar ndihmë për ushtarët e plagosur. Fjalët e tij të mençura që e kanë shtyrë për të ndihmuar dhe për të ofruar mbështetje nga popullsia lokale ishin Siamo tutti frateli! (të gjithë jemi vellezër) në përpjekje për të zgjuar zemrat e vullnetarëve për të siguruar ndihmën e domosdoshme për ushtarët e plagosur. Përveç kësaj Anri Dinan i ka shkruar edhe porositë për familjet me ç'rast ushtarët e plagosur rëndë ia kanë diktuar fjalët e fundit për familjet e tyre. Pas kthimit në Gjenevë derisa akoma i kishte të freskëta përshtypjet nga ngjarjet në Lombardi ka shkruar librin "Kujtimet e Solferinos" përmes së cilit ka arritur të nxisë opinionin publik në gjithë Evropën. Në këtë libër promovohen dy ide thelbësore të cilat më vonë janë treguar si ndër më të mëdhatë në historinë e njerëzimit: Në çdo vend të formohen shoqata për ofrimin e ndihmës në të cilat mbështetja kryesore sigurohet nga vullnetarët në bázë vullnetare që do të kujdesen për të plagosurit gjatë kohës së luftës. Ideja e dytë e madhe që del si rezultat i pasojave të betejës tek Solferino është nevoja e ekzistimit të një marrëveshje ndërkombëtare që do të mbronte ushtarët e plagosur në fushëbetejë dhe ata që kujdesen për ta, duke u siguruar atyre një status neutral, që më vonë ka rezultuar me miratimin e katër Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

Ky humanist i palodhshëm nuk është kënaqur vetëm me shkrimin e librit por në vitin 1863 ka iniciuar formimin e organizatës më të madhe humanitare – Kryqin e kuq, i cili pas 160 vjetësh nga beteja e Solferinos është promotor i humanizmit dhe mbrojtës i personave të prekur nga konfliktet e armatosura dhe katastrofave natyrore. Prandaj gjithmonë duhet të përkujtojmë rëndësinë e njërsës prej betejave më të përgjakshme të shekullit të 19-të – betejën e Solferinos e cila rezultoi me lindjen e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Anri Dinan, në vitin 1901 u bë fituesi i parë i Çmimit Nobel për Paqe për kontributin e tij në formimin e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe inicimit të Konventave të Gjenevës. Kontributi i tij përjetësisht do të mbetet i njohur si vepër i një humanisti të madh i cili ka bërë shumë për mirëqenien e njerëzve anembanë botës.



# 100 VJET NGA THEMELIMI I FEDERATËS NDËRKOMBËTARE TË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE



Federata ndërkombëtare, e themeluar në vitin 1919 është organizata më e madhe humanitare e botës në të cilën janë anëtare 191 shoqata nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe. Misioni kryesor i kësaj organizate prej formimit të saj e deri më sot është përmirësimi i jetës së popullsisë së ceneshe përmes mobilizimit të fuqisë së humanizmit.

Kjo organizatë më e madhe humanitar në botë është formuar më 5 maj të vitit 1919, nga ana e përfaqësuesve të Kryqit të kuq të Francës, Britanisë së Madhe, Italisë, Japonisë dhe ShBA-së me emrin Lidhja e shoqatave të Kryqit të kuq, e cila më vonë në vitin 1991 u riemërua në Federatën Ndërkombëtare të shoqatave të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Angazhimet kryesore të kësaj Federatë Ndërkombëtare me janë që nëpërmjet rrjetit të 191 shoqatave nacionale të sigurojë mbështetje solidare për përforcimin e kapaciteteve të shoqatave nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe anë mbanë botës për zbatimin efikas të aktiviteteve për sigurimin e kujdesit, planit shëndetësor-parandalues dhe social, si dhe mbështetjen e aktiviteteve për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave natyrore. Federata ndërkombëtare gjithashtu siguron edhe mbështetje për refugjatët dhe migruesit të cilët kanë qenë të detyruar të braktisin vendet e tyre si rezultat i veprimeve ushtarake, katastrofave natyrore ose për arsyesh ekonomike.

Federata ndërkombëtare luan rol kyç në mobilizimin, koordinimin dhe drejtimin e ndihmës ndërkombëtare të siguruar përmes Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, partnerët dhe donatorët tjerë ndërkombëtarë qeveritarë dhe joqeveritarë. Federata ndërkombëtare ka mbi 15.5 milionë vullnetarë anembanë botës dhe mbi 415.000 punonjës me mbi 160.000 organizata lokale të Kryqit të kuq/Gjysmëhënës së kuqe. Në vitin 2018 përmes kësaj organizata janë përfshirë 115.4 milionë njerëz nëpërmjet programit përgatishmëri dhe veprim në katastrofa.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në kuadër të shënimit të këtyre jubileve të rëndësishme për Lëvizjen do të organizojë aktivitete të rastit në nivel nacional dhe lokal. Është planifikuar edhe përpunimi i flaerëve për shënimin e 160-vjetorit të "Betejës së Solferinos", "70-vjetorit të miratimit të Konventave të Gjenevës më 12 gusht të vitit 1949" dhe "100-vjetorit të themelimit të Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe". Gjithashtu në kuadër të aktiviteteve të diseminimit të shoqatës sonë nacionale gjatë vitit 2019 janë paraparë gara të diseminimit, kuize dhe ligjërata me grupe të ndryshme qëllimore (studentë, kompani, oficerë të ARM-së dhe pjesëtarë të MPB-së, vullnetarë dhe punonjës në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë dhe grupe të tjera qëllimore).

Shoqata nacionale për se cilën ngjarje do të organizojë aktivitete të përshtatshme me qëllim që të theksohet rëndësia e punës së Kryqit të kuq para publikut të gjërë për të siguruar një mbështetje të vazhdueshme për punën e organizatës sonë në interes të kategorive të ndryshme të popullsisë të cilave u ofrojmë shërbime dhe për promovimin e rolit ndihmës të Kryqit të kuq për pushtetet në vend në përputhje me parimet themelore të Konventave të Gjenevës dhe Protokollet Shtesë.

# 70 VJET NGA MIRATIMI I KONVENTAVE TË GJENEVËS

Sivjet, më 12 gusht shënohet 70-vjetori i miratimit të katër Konventave të Gjenevës të cilat gjithashtu janë quajtur edhe konventa të Kryqit të kuq, të cilat janë me të vërtetë një kthesë e madhe në evoluimin e luftës. Këto konventa janë lindur si rezultat i tmerreve që i ka parë dhe përjetuar tregtari zviceran në fushëbetejën e Solferinos në vitin 1859. Ai ka propozuar idenë universale për kodifikimin e rregullave dhe zakoneve të luftës dhe është meritator për bindjen e shteteve për t'i pranuar dhe respektuar ato.

Konventat e Gjenevës kanë për qëllim të heqin konceptin e "luftës së plotë", siç ishte Lufta e Dytë Botërore gjatë së cilës ndodhën masakra të panumërtë dëshmitarë të së cilëve ishim të gjithë ne, dhe të krijohet një kornizë ligjore e cila do të vendoste kufijtë dhe rregullat e luftës.


Sot, Konventat e Gjenevës përfaqësojnë themelin e së drejtës humanitare ndërkombëtare dhe konsiderohen si marrëveshjet më të rëndësishme që rregullojnë mbrojtjen e viktimate të konflikteve të armatosura. Me këto konventa si viktima trajtohen të lënduarit dhe të sëmurët, ata që kanë pësuar një anijethyerje, të burgosurit e luftës, civilët që jetojnë nën okupim dhe kategori të tjera të civilëve, siç janë gratë, fëmijët dhe personat e zhvendosur.

Konventat janë ratifikuar në mënyrë universale dhe përveç konflikteve të armatosura ndërkombëtare u referohen edhe konflikteve të armatosura jo ndërkombëtare, si rezultat i nenit të përbashkët 3, mini-konventa në kuadër të Konventave, e cila është dispozitë e drejtuar në mënyrë speciale drejt konflikteve të armatosura të karakterit jo ndërkombëtar. Ky nen është me rëndësi të madhe për shkak se në kohët e sotme, me paraqitjen e terrorizmit dhe luftës asimetrike, bota gjithnjë e më shumë po vuan nga konfliktet e armatosura jo ndërkombëtare.

Si rezultat i respektimit të dispozitave të Konventave të Gjenevës janë shpëtuar shumë jetë, është dhënë një ngushëllim i madh për të burgosurit e luftës, janë ndihmuar miliona familje për të bashkuar sërisht dhe është kontribuuar në vendosjen e paqes aty ku është më e nevojshme. Nga ana tjetër, jemi dëshmitarë të shumë cenimeve të Konventave të Gjenevës nga vende të caktuara, grupe të organizuara dhe individë nëpër vite, por derisa në të kaluar këto kundërvajtje kanë kaluar në heshtje, sot situata gradualisht po ndryshon, dhe kundërvajtjet serioze të së drejtës humanitare ndërkombëtare po dënohen në mënyrë rigorozë.

Duke nënshkruar dhe ratifikuar Konventat e Gjenevës nga 196 vende, ndër të cilat edhe Republika e Maqedonisë në vitin 1993, vendet janë dakord për t'i respektuar dispozitat e së drejtës humanitare ndërkombëtare, të përdorin masa të mbrojtjes të së drejtave të civilëve, të rregullojnë mjetet dhe metodat e luftës me qëllim që të kontribuojnë në parandalimin e vuajtjes njerëzore në konfliktet e armatosura dhe të sigurojnë një legjislacion vendor në të cilin njihet përgjegjësia penale e atyre që i shkelin ligjet e së drejtës humanitare ndërkombëtare.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vigjilje të 70-vjetorit të shënimit të Konventave të Gjenevës, përmes organizatave të tija komunale të Kryqit të kuq de Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, do të organizojë tribuna, trajnime, gara për të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe aktivitete të tjera të lidhura me shënimin.



# DREJT STRATEGJISË 2030

Një nga përcaktimet kyç të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në punën e tij është të investojë në përmirësimin e procesit të planifikimit me shpresë se në mënyrën më të mirë do të definohen zgjidhje të përshtatshme për përbushjen e kërkeseve kryesore dhe kapërcimin e sfidave dhe situatave përmes verifikimit të rezultateve të cilat në mënyrën më të mirë të mundshme do të zgjidhin problemet dhe nevojat e identifikuara. Prosesi i planifikimi i definon aktivitetet dhe resurset që janë të nevojshme për realizimin e këtyre rezultateve. Planifikimi është vërejtur dhe theksuar si thelbë i menaxhimit të mirë dhe llogaridhënie para partnerëve, donatorëve dhe përdoruesve të shërbimeve. Në Kryqin e Kuq të Maqedonisë, procesi i planifikimit shihet si një proces i përgjedhjes së aktiviteteve të përgjedhura në dispozicion dhe dhënie e përparrësë për hapat që duhet të ndërmerren për të ndryshuar një situatë të caktuar për të mirë. Planifikimi në Kryqin e kuq zhvillohet në dy nivele. Planifikimi strategjik dhe operativ. Të dyja llojet e planifikimit janë pjesë përbërëse të procesit të përgjithshëm të përcaktimit të prioriteteve dhe qëllimeve të organizatës.

Planifikimi strategjik është proces i vendimmarrjes në çfarë drejtimi do të lëvizë në aspekt afatgjatë Organizata, si dhe përgjedhja e prioriteteve dhe aktivitetave për realizimin e qëllimeve të dëshiruara. Planifikimi strategjik ndihmon organizatën për të përcaktuar qartë të ardhmen e saj si përgjigje e të gjitha mundësive dhe sfidave në dispozicion, dhe njëkohësisht duke ruajtur pajtueshmërinë dhe qëndrueshmërinë afatgjate. Kjo siguron drejtime të përgjithshme për Organizatën përmes përcaktimit të vizionit dhe misionit dhe qëllimeve strategjike të cilat janë të domosdoshme për realizimin e tyre. Planifikimi strategjik në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë është inkorporuar si mjet zhvillimor dhe si një mënyrë e të menduarit dhe të punuarit së shpejti pas pavarësimit të Shqatës nacionale.

Organizata deri tani ka përgatitur tre dokumente afatgjata zhvillimore të cilët janë korniza e punës së organizatës. Në këtë moment është duke u bërë implementimi i Strategjisë 2020 e cila është një udhërrëfyes i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në punën në periudhën 2010-2020.

Në vitin 2018 ka filluar procesi për përpunimin e një kornize të re dhjetëvjeçare zhvillimore për periudhën e vitit 2020-2030. Është formuar një grup i punës i përbërë nga përfaqësues të strukturës udhëheqëse dhe administrative të shoqatës nacionale e cila në vitin 2019 do të punojë në përgatitjen e Strategjisë së re 2030 e cila para së gjithash do të ketë për qëllim të bëjë evalvimin e realizimeve të Strategjisë 2020, trendët, ambiciet tona dhe rrugen tonë që do ta zgjedhim për dekadën e ardhshme përmes punës hulumtuese, një proces i gjërë këshillues në shoqatën nacionale, skenimin e gjendjeve të mjedisit shoqëror, dhe krijimin e një vizioni të ri si do të punojmë në rrethanat e reja. Strategjia do të përfaqësojë një plan si ne do të organizohemi dhe do të strukturohem, cili do të jetë roli ynë dhe në cilat fusha do të drejtojmë vëmendjen dhe resurset tona. Do të përpinqemi për të dizajnuar parimet e punës sonë që do të na udhëheqin drejt sukseseve të reja, me qëllim që t'i realizojmë ambiciet tona.



## ZHVILLIMI ORGANIZATIV

Zhvillimi i organizatës është një proces i vazhdueshëm i nevojshëm për të siguruar përparimin dhe funksionimin efikas të shoqatës nationale. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vazhdimeshit ka punuar në ndërmarrjen e masave për avancimin e përmirësimit të kapaciteteve në nivel nacional dhe lokal para së gjithash për të ndërtuar një organizatë të fuqishme të aftë për t'iu përgjigjur sfidave të ndryshme në interes të kategorive të ceneshe me të popullsi të për të cilat ofron shërbime. Aktivitetet në këtë fushë do të vazhdojnë të zbatohen përmes implementimit konsekuent të dispozitave statutore të statutit të miratuar kohët e fundit të organizatës si dhe rregulloret e reja që rregullojnë më tej punën e organizatës. Praktikat e mira dhe rezultatet në fushën e zhvillimit organizativ na bindin se edhe sivjet do të bëjmë edhe një hap pozitiv për të përmirësuar kapacitetet e organizatave tonë komunale dhe me sukses t'u përgjigjemi sfidave me të cilat përballemi në bashkësitetë lokale. Do të vazhdojmë të inkorporojmë standardet më të larta në punën me qëllim të sigurimit të shërbimeve cilësore dhe në kohën e duhur për përdoruesit tanë përmes mobilizimit dhe organizimit të resurseve njerëzore dhe materiale në dispozicion. Si ndihmës të autoriteteve në shtet, të gjitha kapacitetet do të përdoren për të kontribuuar pozitivisht në rrjedhat e përgjithshme shoqërore në Republikën e Maqedonisë. Një theks i veçantë në punën e shoqatës nationale në vitin 2019 do të jetë investimi në njoħuritë organizative dhe përmirësimin e kompetencave dhe shkathtësive të resurseve njerëzore në organizatë. Kjo nga ana tjetër do të duhet të mundësoj një punë të qëndrueshme dhe efektive me mjetet financiare të organizatës dhe një zhvillim i vazhdueshëm i aktiviteteve të programit dhe projektit.

Gjatë vitit 2019 shoqata nationale një theks të veçantë do të vë në disa aspekte të lidhura me zhvillimin organizativ. Një nga fushat do të jetë sigurimi i vazhdimesisë në integrimin e softuerëve të rinj të cilët kanë për qëllim të sistematizojnë bazat e të dhënavët në shoqatën nationale në veprimtari të ndryshme programore si dhe për të siguruar një mjet të evalvimit për të ndjekur punën në të gjitha pjesët integrale të organizatës.

Aktiviteti i dytë kyç në këtë sferë do të jetë aplikimi i metodologjisë së re për monitorimin e performanseve të punës së sekretarëve dhe organizatave komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Integrimi i mjetit të ri të evalvimit dhe monitorimit do të kontribuojë në monitorimin e rregullit të rezultateve të realizuara dhe monitorimin e sfidave në organizatë me qëllim që të ndërmerren masa të duhura për avancimin e punës së shoqatës nationale.

Një nga sfidat kyç në vitin 2019 do të jetë inkorporomi i paketës së rregulloreve të miratuarë të shoqatës nationale në nivelin lokal që rregullojnë aspekte të ndryshme të zhvillimit organizativ të cilat janë me rëndësi thëlbësore për punën e resurseve njerëzore të shoqatës nationale.




## Lidhjet dhe partneritetet operative.

Organizata do të vazhdojë aktivitetet për ndërtimin e partneriteteve të reja dhe avancimin e partneriteteve ekzistuese me shoqatat nacionale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, organizatat ndërkombe, institucionet shtetërore dhe korporatat me qëllim që të sigurohet vazhdimi së sigurimin e mbështetjes programore dhe të projektit për shoqatën nacionale. Gjatë këtij viti do të organizohet një takim i partneritetit në të cilin do të prezantohen iniciativat e shoqatës nacionale para organizatave partnere për sigurimin e mbështetjes së projektit. Do të vazhdojnë aktivitetet për avancimin e bashkëpunimit të shoqatave nacionale të rajonit përmes kornizës për bashkëpunim "Fqinjët ndihmojnë të parët".

## Ngritja e kapaciteteve të punonjësve dhe vullnetarëve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Shoqata nacionale do të vazhdojë organizimin e rregullt të trajnimeve profesionale për resurset njerëzore në veprimtari të ndryshme programore. Trajnimet do të orientohen drejt ngritjes së kapaciteteve të strukturës udhëheqëse dhe administrative të organizatës në nivel nacional dhe lokal. Theks i veçantë në këtë sferë do të vihet në implementimin e projektit për përfocimin e rezistueshmërisë së shoqatës nacionale në veprimtari të ndryshme programore që duhet të kontribojë në përmirësimin e kompetencave të resurseve njerëzore të organizatës për përgatitjen e aplikimeve të projektit.



## Térheqja dhe mbajtja e vullnetarëve.

Puna e Kryqit të kuq mbështetet në kontributin e vullnetarëve në komunitetet në të cilat punojmë. Vazhdojmë të punojmë në térheqjen e individëve të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetet që përforcojnë komunitetet. Angazhimi ynë kryesor mbetet të promovojmë bashkëjetesë dhe mundësi të njëjta si dhe diversiteti të jetë një stimul dhe sfidë në ndërtimin e paqes dhe tolerancës përmes bashkëjetesës së njerëzve që bëjnë pjesë në grupe të ndryshme etnike, kulturore dhe të religjionit dhe promovimin e dhembshurisë, miqësisë dhe respektimit ndërmjet njerëzve. Vullnetarët mbeten angazhimi ynë kryesor me qëllim që të mund të sigurojmë potencial që do ta mundësojë kontributin tonë në komunitetet lokale.

## Takimet e punës me sekretarët dhe kryetarët e OKKK-ve.

Në vitin 2019 do të realizohen 2-3 takime të rregulla kordinatave të punës dhe trajnime të shoqatës nacionale dedikuar për përmirësimin e kapaciteteve të sekretarëve dhe kryetarëve të OKKK. Në vazhdimi së do të ndërmerren aktivitet për përparimin e shkathtësive dhe kompetencave të punonjësve, térheqjen dhe mbajtjen e një potenciali adekuat udhëheqës i cili do të jetë në gjendje për t'u përbalitur me të gjitha sfidat në komunitetet lokale me çka do të japid një kontribut të përbashkët për zhvillim efektiv dhe përparim të shoqërisë.

# AVANCIMI I VULLNETARIZMIT NË KRYQIN E KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Vullnetarizmi përfaqëson bazën e punës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në të cilin bazohen të gjitha aktivitetet që i zbaton për grupet e veta qëllimore. Puna me vullnetarët në nivel lokal dhe nacional është rregulluar me shumë akte dhe zbatohet me mjete të ndryshme varësisht nga lloji i programit ose i aktivitetit. Në vitin 2019 do të bëhet një përforcim shtesë i kapaciteteve në nivel lokal dhe nacional për menaxhim më efektiv të vullnetarëve dhe të programeve të vullnetarëve.

## Ndihma e parë psikologjike, mbështetja psiko-sociale dhe menaxhimi i vullnetarëve spontanë.

Në kuadër të projektit "Ndihma e parë psikologjike dhe mbështetja psiko-sociale në situata emergjente" i mbështetur nga BE-ja, janë zhvilluar mjete të menaxhimit me vullnetarët dhe punonjësit duke vënë theksin e veçantë në gjendjen e tyre psikike para dhe pas angazhimit të tyre. Mjetet në vitin 2019 parashihet të diseminohen deri te organizatat komunale dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit, dhe ato të inkorporohen në modulet aktuale të trajnimit dhe praktikave operative në rast të gjendjeve të jashtëzakonshme.

## Orientuesit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

Në vitin 2018 u aplikua programi pilot i cili parashesh një qasje të unifikuar për pranimin e të gjithë personave të interesuar për të qenë pjesë e organizatës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në rolin e vullnetarëve, anëtarëve ose mbështetësve. Kjo fazë pilot do të zgjasë deri në maj të vitit 2019 kur procesi do të rishikohet dhe do të përgatitet një komplet për orientues me një manual të rishikuar, formularë dhe drejtime për punën në terren.

## Aplikimi i softuerit për menaxhimin e vullnetarëve.

Gjatë vitit do të monitorohet udhëheqja e unifikuar e evidencës së orëve dhe aktiviteteve të vullnetarëve në të gjitha organizatat komunale dhe Kryqin

e kuq të qytetit të Shkupit me softuerin e përgatitur në mënyrë të veçantë. Për mbajtjen dhe përdorimin e drejtë janë parashikuar trajnime në përpunje me nevojat e përdoruesve, dhe ai do të jetë objekt i ngritjes dhe zhvillimit të vazdueshëm duke shtuar segmente dhe mundësi të reja.

## Aplikimi i anëtarësimit onlajn dhe bashkimi me Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë.

Duke ndjekur trendët modernë dhe zhvillimin e teknologjisë, faqja e internetit e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë do të përmirësohet me mundësi për anëtarësim direkt dhe pagesë të anëtarësimit nga ana e çdo personi të interesuar pa qenë e nevojshme me këtë rast të vijë fizikisht në lokalet e Kryqit të kuq. Përforcimi i efikasitetit në menaxhimin me të dhënat dhe financat përmes evidentimit dhe pagesës elektronike do të avancojë në mënyrë shtesë Shoqatën nationale në përpjekjet përmobilizimin e resurseve njerëzore.

## Shënim i Ditës Botërore të Vullnetarizmit 5 Dhjetori.

Tradicionalisht më 5 dhjetor në nivel nacional do të mbahet një ngjarje për dhënien e mirënjojve për individë dhe forma të organizimit të punës vullnetare që kanë realizuar rezultate më të mira gjatë vitit të kaluar.



# TË RINJTË E KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Gjatë vitit 2019 Rinia e Kryqit të kuq do të konfirmojë rolin e saj si forcë lëvizëse e aktivitetave në terren të shoqatës nationale, iniciatorë të ideve të reja dhe liderë në mjediset e tyre të veprimit. Me qasjen e tyre pro-aktive dhe gatishmërinë për t'u përballur me sfidat e reja ata do të jenë një pjesë e rëndësishme e shoqatës nationale në arsyetimin e epitetit të marrë si shoqatë "e fuqishme" nationale e përgatitur për t'iu përgjigjur sfidave humanitare të popullsisë lokale.

## Zgjedhjet e rregullta tek të rinjtë për periudhën e mandatit të vitit 2019-2021.

Viti 2019 është një vit zgjedhor në strukturën e të rinjve të Kryqit të kuq. Të rinjtë në nivel lokal dhe nacional do të zgjedhin përfaqësuesit e tyre të cilët do t'i udhëheqin në periudhën e ardhshme të mandatit dyvjeçar.

## Përforcimi i sistemit të veprimit përmes klubeve shkolllore të Kryqit të kuq në shkollat fillore.

Gjatë periudhës së verës do të bëhet evalvimi i fazës pilot të veprimit përmes klubeve shkolllore e iniciuar në 54 klube shkollore në vitin 2018. Për rezultatet e marra do të bëhen drejtime dhe përgatitje për veprimin e gjithmbarshtëm në të gjitha shkollat fillore me çka direkt do të ndikohet në gamën e aktivitetave si dhe në numrin e grupeve qëllimore të përfshira me programet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

## Akademia për vullnetarët e rinj të Kryqit të kuq.

Gjatë periudhës së dimrit është parashikuar "Akademia për vullnetarët e rinj" ose një trajnim i plotë i vullnetarëve i cili do të ndikojë ndjeshëm në aktivitetet e programit të të rinjve në organizatat komunale. Në vitin 2019 është parashikuar një akademi për trajnimin e trajnerëve të edukatorëve të bashkëmoshtarëve, me çka do të aftësoheshin 25 trajnerë që do të mund të mbajnë trajnime në nivel lokal. Duke aplikuar mundësitet e këtilla për trajnime lokale, do të rritet numri i personave të rinj që posedojnë shkathtësi për edukimin e bashkëmoshtarëve të tyre dhe ndjeshëm do të ulen shpenzimet për implementimin e programeve të parandalimit të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.

## Fushata për promovimin e aktivitetave të të rinjve në Kryqin e kuq.

Në kuadër të shënimit të Javës kalendarike të të rinjve 01-07 Tetor, do të organizohet një fushatë për promovimin e aktivitetave të të rinjve me qëllim të tërheqjes së vullnetarëve dhe bashkëpunëtorëve potencialë. Fushata do të përfshijë ngjarje publike të organzuara nga klubet e të rinjve, publikime të

unifikuara të promovimit, drejtime të promovimit përmes rrjetave sociale etj.



## Organizimi i kampeve verore për përforsimin e kapaciteteve të liderëve, zëvendësve të liderëve dhe përfaqësuesve në Këshillin e të rinjve.

Në periudhën verore tradicionalisht do të organizohen kampe verore për liderët sa po të zgjedhur në klubet e të rinjve për të marrë njojuri dhe shkathtësi për organizimin e të rinjve në klubet e tyre, mbajtjen e mbledhjeve, krijimin e aktivitetave, transmetimin efektiv të informacioneve, njojjen më të mirë me strukturën dhe aktivitetet e shoqatës nationale, ngritjen e iniciativave në nivel lokal dhe nacional, krijimin e planeve dhe raporteve vjetore, njojjen me dokumentet relevante që rregullojnë punën e të rinjve në kuadër të Lëvizjes, Shoqatës nationale si dhe shtetit që kanë një rëndësi të madhe për punën e klubave të të rinjve.

## BASHKËPUNIMI I PARTNERITETI NË SUAZA NDËRKOMBËTARE

Mandati ynë dhe roli humanitar i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë kërkojnë që ne vazhdimesht të përpinqemi për të ndërtuar ura midis kulturave, popujve, klasave shoqërore dhe individëve të ndryshëm. Në kushte kur në mjeshterët shoqëror jemi ballafaquar me sfida lokale dhe globale nga më të ndryshmet, me rëndësi thelbësore për organizatën tonë është të sigurojmë vazhdimësi në vendosjen dhe mirëmbajtjen e partneriteteve strategjike me komponentët e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe organizatat ndërkombëtare, me qëllim që të mundësohet mbështetja e mirëqenies së njerëzve me nevoja dhe grupet e marginlizuara.

Megjithatë sa do të jemi të suksesshëm në ballafaqimin me sfidat varet nga gatishmëria dhe aftësia jonë për të punuar në bashkëpunim me partnerët tanë përmes kultivimit të marrëdhënieve të mira të partneritetit dhe respektimit të ndërsjellë të vlerave dhe roleve thelbësore. Këto angazhime institucionale i përkthejmë në aksione praktike përmes mobilizimit efikas të mbështetjes humanitare nga partnerët ndërkombëtare dhe partnerët lokalë në vend. Projektet dhe programet tona dhe mbështetja të cilën e sigurojmë në masë të madhe mbështeten në mobilizimin efikas të mbështetjes humanitare nga partnerët ndërkombëtarë dhe partnerët lokalë në vend.

Një pjesë të konsiderueshme të aktiviteteve i implementojmë me partnerët tanë siç janë Federata Ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Komiteti Ndërkombëtare i Kryqit të kuq, shoqatat nationale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe, agjencitë e Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

Edhe sivjet theks i veçantë do të vihet në përparimin e bashkëpunimit bilateral të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë në nivel nacional dhe lokal me shoqatat nationale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe me qëllim që të sigurohet një shkëmbim i irregullt përvojave, i materialit informativ dhe ndihmës profesionale në drejtim të përmirësimit të kualitetit të shërbimeve për popullsinë e ceneshe. Veçanërisht bëhet fjalë për kultivimin dhe përparimin e bashkëpunimit bilateral me vendet e rajonit përmes zbatimit të planeve vjetore të aksionit për bashkëpunim.

Resultatet e mirëbesimi që është marrë para organizatave partnere mundësojnë që Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë edhe në vitin 2019 të bëjë implementimin e projekteve dhe programeve të finançuara nga donatorë ndërkombëtare për ngritjen e kapaciteteve dhe mbulimin e nevojave të kategorive të ceneshe të popullsisë në Republikën e Maqedonisë. Programet dhe projektet që do të implementohen me mbështetjen ndërkombëtare në vitin 2019 janë pjesë përbërëse e veprimitarive të prezantuara programore në këtë dokument.



## KOMUNIKIMI DHE ELEMENTET E PROCESIT TË KOMUNIKIMIT

Gjatë historisë, prirja e njeriut për të komunikuar në mënyrë efektive gjithmonë ka qenë faktor që ka përcaktuar hendekun e inteligjencës ndërmjet kafshëve dhe njeriut. Raporti në mes përparimit të civilizimit dhe përparimit të teknologjisë së komunikimit është raport i dobisë së ndërsjellë; për shkak se zhvillimi i metodave superiore të komunikimit i mundëson shoqërisë për të përparuar, dhe përparimi i shoqërisë është i domosdoshëm për zhvillimin e metodave të reja të komunikimit. Në kuptimin tradicional, përparimi i teknologjisë së komunikimit, gjithashtu i adreson edhe tre aspektet e vetme të transferimit të informacioneve, dhe këto janë: shpejtësia dhe distanca në të cilën mund të dërgohen dhe prahohen informatat, fuqia e informacioneve, si dhe vëllimi i informacioneve që mund të dërgohen.

Për të punuar në mënyrë të suksesshme gjatë vitit 2019 shoqata nacionale do të ndërmerr një sërë aktivitetesh për përmirësimin e komunikimit dhe përparimin e marrëdhënieve me publikun. Obligimi ynë është të jemi transparentë dhe përgjegjës në punën tonë, ndërsa sfidë përfaqësojnë mjetet përmes së cilave do të promovohem.


**Mediat sociale të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë.** Vazhdimesht do të përmirësohen dhe do të sigurohet hapësirë për publikimin e një numri të madh informacionesh të llojillojshme, struktura e të cilave targeton kategori të ndryshme vizitorësh. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë me qëllim të komunikimit më të suksesshëm me publikun onlajn, do të ndërmerr një qasje integruese dhe bashkëpunuese të të praktikuarit të rrjetave sociale.

**Botimet javore në gazetën elektronike të Kryqit të kuq INFO.** Janë shembull i një mjeti të suksesshëm të informimit për vullnetarët, partnerët, bashkëpunëtorët dhe mbështetësit lidhur me aktivitetet që i realizojnë në nivel lokal, nacional dhe ndërkombëtar. E-gazeta edhe më të tej do të botohet dy herë në javë dhe gjatë vitit 2019 parashihet botimi i saj deri në 100 numra.

**Materialet e promovimit.** Janë përcaktuar në ligjin e Kryqit të kuq, të cilat janë nevojë e një numri të madh të aktiviteteve të projektit dhe të dokumenteve strategjike në kuadër të veprimtarisë botuese të shoqatës nationale edhe sivjet rregullisht do të punohen me përbajtje kreative dhe atraktive edukative. Në bashkëpunim me Postën e Maqedonisë do të lëshohen pulla postare me përbajtje të lidhura me kalendarin tradicional të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë. Kryqi i kuq duke lëshuar pulla postare me pagesë shtesë nga ana e Postave të Maqedonisë, si dhe me lëshimin e materialeve filatelike zarfet FDC, karta maksimale dhe përdorimin e shenjave të përshtatshme përmes markat, siguron mbështetje për realizimi e programeve të veta që kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së popullsisë. Planet e ardhshme të Kryqit të kuq të RM-së për veprimtarinë filatelike, lëvizin në drejtim të përgatitjes së strategjisë zhvillimore.

**Organizimi i rregullt i konferencave për shtyp dhe brifingjeve për gazetarët.** Kanë për qëllim të afrojnë organizatën për mediat dhe njëkohësisht të sigurojnë kumtesa për mediat për aktivitetet programore dhe të projektit.

**Marrëdhëniet me mediat dhe trajnimet specifice për gazetarët.** Vazhdojnë në drejtim të diseminimit të aktiviteteve të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë deri te mediat dhe sigurimi i mbështetjes së mediave për aktivitetet tona. Këtë vit me trajnim do të përfshihen 15 gazetarë të mediave elektronike dhe të shkruara.



## DISEMINIMI

Përmes programit të diseminimit do të promovohen arsimi humanitar si qasje e Lëvizjes që përfaqëson platformë arsimore për edukimin humanitar, mobilizimi dhe perspektiva e tërheqjes së vullnetarëve, anëtarëve dhe mbështetësve të rinj në organizatë, për ngritjen e ndërgjegjes publike për rëndësinë dhe rolin e Kryqit të kuq në vend dhe në suaza ndërkomëtare si dhe rëndësia për nevojën e mbrojtjes së emblemës dhe personelit të Kryqit të kuq në kryerjen e mandatit dhe detyrës së tij në përputhje me Konventat e Gjenevës dhe Protokollet Shtesë dhe Ligjin për Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë.

Promovimi i veprimit humanitar, nxit aplikimin praktik të vlerave universale, jo dhunës dhe paqe, vlerave humane, kulturës së dialogut për mirëkuptim dhe tolerancë të ndërsjellë, njoħuri aktive dhe marrëdhënie aktive ndaj jetës, marrëdhënie humane pa diskriminim dhe kufizim, promovim të vlerave pozitive të veprimit në komunitete përmes parimeve themelore të veprimit humanitar i cili kryesisht fokusohet në një sistem të unifikuar dhe një qasje adekuate metodologjike të diseminimit.

Në vitin 2019 do të punohet drejt zbatimit të diseminimit një formë e edukimit në kuadër të Kryqit të kuq, përmes organizimit të 180 sesioneve të diseminimit me grupe të ndryshme qëllimore në OKKK dhe KKQSh, zbatimin e dy trajnimeve për diseminues të rinj në pjesën e DHN-së, aktivitete të Klubit për DHN.

## E DREJTA HUMANITARE NDËRKOMBËTARE

Implementimi i të drejtës humanitare ndërkomëtare (DHN) si një segment i të drejtës ndërkomëtare që bashkon instrumentet ndërkomëtare – juridike që aplikohen në rast të konflikteve të armatosa me qëllim të kufizimit të pasojave të tyre, éshtë çështje të cilës bashkësia ndërkomëtare dhe shtetet i kushtojnë vëmendje të veçantë. E drejta humanitare ndërkomëtare éshtë një detyrim ligjor dhe statutar i shoqatave nacionale për diseminimin, promovimin, implementimin dhe afirmimin e saj.

### Komiteti nacional i Të Drejtës humanitare ndërkomëtare.

Komiteti nacional i Të Drejtës humanitare ndërkomëtare me seli në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë éshtë formuar si një trup koordinues operativ nacional në RM në përputhje me instrumentet ndërkomëtare të fushës së DHN-së si një segment i të drejtës ndërkomëtare anëtar i së cilës éshtë Republika e Maqedonisë, për shkak të sigurimit të implementimit të tyre efikas në nivel nacional.

Nga viti 2019 deri në vitin 2021 do të kryesojë një përfaqësues i Ministrisë së Shëndetësisë. Komiteti nacional i DHN-së edhe në vitin 2019 do të rishikojë çështje dhe do të japë rekomandime në lidhje me: harmonizimin e legjislacionit nacional me të drejtën humanitare ndërkomëtare; implementimin efektiv të DHN-së përmes ndërmarrjes dhe monitorimit të masave praktike dhe aktiviteteve; monitorimin e DHN-së dhe diseminimin e saj në segmente të ndryshme të jetës shoqërore; përparimin e bashkëpunimit midis institucioneve kompetente duke përfshirë edhe bashkëpunimin me Kryqin e kuq të Republikës



së Maqedonisë, në drejtim të identifikimit të aktiviteteve që dalin nga fusha e DHN-së dhe dispozitat ligjore.

### Klubi i diseminuesve për të drejtën humanitare ndërkomëtare.

Klubi do të përbëhet nga 10 persona profesionalë universitarë për DHN-në në funksion të Kryqit të kuq. Klubi i diseminuesve të DHN-së do të përgatitë një program vjetor i cili do të ndjekë trendët në këtë fushë, do të organizojë konferanca, tribuna – DHN për parlamentarët, gara të DHN-së ndërmjet universiteteve në RM, shkollë verore/kamp veror me një program specifik, shkëmbim të vazhdueshëm të përvjave me persona të tjera profesionalë dhe ShN.

## KRYQI I KUQ NË AKSION – PROMOVIMI I VLERAVE HUMANE (KKA-PVH)

“Kryqi i kuq në aksion – Promovimi i vlerave humane” (KKA-PVH) është një produkt vendor i cili funksionon tanimë 20 vjet si një mjet nacional për tërheqjen dhe mbajtjen e vullnetarëve në radhët e Kryqit të kuq. Ai është krijuar në bázë të nevojave dhe prioriteteve të Shoqatës sonë nationale, por edhe të zakoneve lokale, normat dhe vlerat kulturore. Misioni i tij i përhershëm është promovimi i kulturës së dialogut si një parakusht kryesor për ndërtimin e një shoqërie ndërkulturore dhe promovimin e njohurisë aktive dhe qasjes aktive ndaj jetës, përmes vlerave dhe parimeve të Kryqit të kuq.

Qëllimet e përgjithshme të programit KKA-PVH janë: krijimi i modelit të diseminimit për të rinjtë, promovimi i kulturës së dialogut, ndërlidhja e diseminimit dhe aktivitetave humanitare dhe rekrutimi dhe mbajtja e vullnetarëve të rinx në Kryqin e kuq.

Programi ka 30 instruktorë të trajnuar nacional PVH të cilët formojnë Kolegjumin KKA-PVH. Janë trajnuar edhe 40 diseminues të cilët direkt janë mentoruar nga ana e instruktorëve për të zbatuar më lehtë dhe më mirë programin në çdo organizatë komunale.

Në ciklin KKA-PVH për vitin 2019, si dhe vitin e kaluar, OKKK-ve do t'u ofrohet një opsjon për të aplikuar dhe kotizuar për pjesëmarrje në këtë program. Pritet një numër prej 900 të rinjsh të përpunojnë ndërmjet 120 dhe 150 projekte të vogla në dobi të komunitetit në të cilin jetojnë, duke u ndihmuar direkt rreth 2.500 deri 3.000 individë të grupeve të ndryshme të ceneshme në RM. Një përqindjeje të madhe të këtyre personave përmes këtyre projekteve u ndryshohen kushtet e përditshme të jetesës, dhe ato përmirësohen. Por, gjithashtu një numër i madh i projekteve përbëhen nga donacione ose mbështetje të spitaleve, qendrave ditore për personat me aftësi të kufizuar trupore, shkollat, çerdhet e fëmijëve, objektet kulturore dhe vendet publike, dhe përfaqësojnë mbështetje direkt në komunitetet prej nga vijnë të rinjtë. Me këtë numri i personave që ndjejnë përfitimin direkt nga projektet rritet shumëfish.

Në kuadër të ciklit, do të realizohen dy punëtori përgatitore për instruktorë të PVH-së, 100 trajnime nga ana e instruktorëve dhe diseminuesve të cilët do të trajnohen për ciklin e ardhshëm si dhe një punëtori finale dyditore për 80 pjesëmarrës në të cilat të rinjtë më të mirë do të marrin njohuri të thelluara për Kryqin e kuq, punën ekiplore, shkathtësitë e liderit dhe kulturën si një sistem i vlerave. Në fund të ciklit, do të realizohet edhe trofeu PVH, mirënjojje për të rinjtë të cilët kanë punuar projektet më të mira dhe gjithsesi java PVH përmes së cilës të rinjtë promovojnë tolerancën, paqen dhe bashkëjetesën në vendin tonë.

Programi u ofron mundësi të rinjve për të ndërlidhur teorinë ghe praktikën, dhe njëherësh ata kanë mundësinë për të krijuar ndjenjën për kulturën e tyre, si dhe ndjenjën për kulturat tjera. Programi gjithashtu promovon qasje aktive ndaj jetës dhe ndryshon rutinën e përditshme të të rinjve.



## VEPRIMTARIA SHËNDETËSORE PARANDALUESE

Në krijimin e aktiviteteve shëndetësore, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë udhëhiqet nga nevojat specifike shëndetësore si të individëve, ashtu edhe të komuniteteve në nivel lokal, dhe me vëmendje të veçantë të grupeve më të ceneshme të popullsisë.

Qasje multidisiplinare në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve parandaluese shëndetësore është me rëndësi parësore për arritjen e rezultateve të pritura në planin parandalues shëndetësor, që është në interes të gjithë palëve të përfshira, dhe veçanërisht të përdoruesve finalë, të atyre për të cilët janë dedikuara këto.

Trajtojmë popullsinë e përgjithshme të territorit të RM-së duke vënë theksin në grupet e ceneshme të popullsisë: nënrat, foshnjat dhe fëmijët e vegjël, popullsia e re, popullsia nga zonat rurale me një qasje të vështirë deri te institucioni shëndetësor, personat që përdorin droga, sidomos përdoruesit intravenozë, personat që praktikojnë sjellje të rrezikshme për marrjen e HIV-it dhe sëmundjet e tjera seksuale, personat e sëmurë nga tuberkulozi si dhe personat që bëjnë pjesë në grupin e rrezikut, me mundësi për të marrë TBC, personat e diskriminuar dhe të marginalizuar të cilët kanë nevojë për kujdes shëndetësor-parandalues.

Në përputhje me Ligjin e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, tradicionalisht shënojmë katër javë nga të cilat tri bëjnë pjesë në veprimtarinë shëndetësore parandaluese: Javën e luftës kundër kancerit, Javën e luftës kundër tuberkulozit dhe sëmundjet e gjoksit, Javën e luftës kundër sidës dhe Javën e luftës kundër sëmundjes së sheqerit.

**Mbajtja e përhapjes së ulët të HIV-it në Republikën e Maqedonisë.** Si partner i Ministrisë së Shëndetësisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vazhdimësi ndërmerr aktivitete për mbajtjen e përhapjes së ulët të HIV-it në Republikën e Maqedonisë. Duke u kujdesur për grupet më të ceneshme të popullsisë siç janë përdoruesit intravenozë të drogave në tri qendrat në Veles, Prilep dhe Kërçovë përmes programeve të vendosura për uljen e pasojave të dëmshme nga përdorimi i drogave përpinqemi për të dhënë kontribut në uljen e rrezikut të HIV/SIDA, hepatiti B dhe C dhe infekzionet e tjera të transmetueshme seksualisht, mbidozimi dhe pasojat shëndetësore dhe dëmet sociale, si dhe risocializimi dhe ri-integrimi i përdoruesve të drogës në shoqëri.

### Kontribuojmë në uljen e numrit të sëmurëve nga tuberkulozi.

Kryqi i kuq synon uljen e numrit të rasteve të reja të tuberkulozit përmes ngritjes së ndërgjegjes publike, distribucionit të materialit edukativ informativ duke vënë theksin në grupet më të rrezikuara të popullsisë për t'u sëmurë nga tuberkulozi, lobimi tek bartësit e vendimeve përmobilizimin e resurseve.

**Mbrojtja e shëndetit në kushte të ndryshimeve klimatike.**

Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë si dhe me institucione të tjera qeveritare dhe jo-qeveritare në nivel lokal dhe nacional, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në përputhje me planin e aksionit për valët e ngrrohta vazhdon të zbatojë aktivitetet. Aktivitetet janë orientuar drejt mbrojtjes së shëndetit të popullsisë nga valët e ngrrohta, ngritjen e ndërgjegjes publike përmes pasojat e mundshme nga e njëta, si dhe edukimin përmes masat e mundshme parandaluese të cilat çdo individ mund dhe duhet t'i ndërmarrë me qëllim që të mbrojë shëndetin e tij dhe shëndetin e të afërmve.

Në përputhje me kushtet e motit gjatë periud-



hës dimërore, duke marrë parasysh edhe nevojat e popullsisë, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është përgatitur për të reaguar në kohën e duhur duke ndërmarrë aktivitete të ndryshme në drejtim të mbrojtjes së shëndetit të popullsisë nga pasojat në shëndetin që mund të paraqiten si rezultat i ekspozimit në temperaturat e jashtme ekstreme të ulëta duke vënë theksin në grupet më të ceneshme të popullsisë, si të pastrehët, familjet e varfër sociale, personat e moshuar, fëmijët etj.

# NDIHPMA E PARË – NË DISPOZICION PËR TË GJITHË

Trajnim i për ndihmën e parë është me rëndësi thelbësore, para së gjithash për të ngritur ndërgjegjen publike të popullsisë pér shpëtimin e jetës së njerëzve dhe pér krijimin e kushteve pér përgjigje më efikase ndaj gjendjeve emergjente dhe katastrofave natyrore. Ndihpma e parë nënkupton veprim emergjent, me ndihmën e teknikave dhe shkaktësive që mbrojnë dhe shpëtojnë jetën e njeriut, derisa person të mos stabilizohet ose të marrë një ndihmë profesionale mjekësore.

## Ndihpma e parë është në dispozicion për të gjithë.

Qëllimi ynë është të paktën një person në çdo familje të ketë mundësi pér të mësuar shkaktësitet pér ofrimin e ndihmës së parë, pa marrë para-sysh statusin e tij socio-ekonomik ose faktorë të tjerë potencial diskriminues. Do të zbatohen një numër i madh aktivitetesh që do të orientohen drejt promovimit të ndihmës së parë në të gjitha segmentet e jetës me theks në rëndësinë e ndihmës së parë në trafik dhe në vendin e punës.

Përkushtimi i Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë ndaj ndihmës së parë është me qëllim që të shpëtohen jetë të njerëzve, ulja e vuajtjeve, parandalimi i invaliditetit dhe përmirësimi i cilësisë së jetës.

**Edukimi në fushën e ndihmës së parë** është një segment i rëndësishëm në promovimin e aktiviteteve shëndetësore parandaluese në rast të aksidenteve të trafikut, ndihma e parë në organizatat e punës dhe pér kandidatët pér shoferë, ndihma e parë pér personat përdorues të alkoolit ose drogës dhe pér kategoritë tjetra. Shërbimet dhe edukimi në fushën e ndihmës së parë, duhet të jetë në përputhje me aktet normative që rregullojnë këtë problematikë, me qëllim që të sigurohen standardet e nevojshme në ndihmën e parë. Me një trajnim adekuat dhe trajnime efikase të ndihmës së parë, vullnetarët e Kryqit të kuq mund të kontribuojnë në përforcimin e rezistencës së individëve dhe komuniteteve, në gatishmërinë dhe veprimin në jetën e përditshme dhe në rast të katastrofave.

**Angazhimet parësore në sferën e ndihmës së parë**, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do t'i realizojë përmes: zbatimit të kurseve të ndihmës së parë pér kandidatët pér shoferë, kurset e ndihmës së parë pér organizatat e punës, kurset e ndihmës së parë pér grupet e ndryshme qëllimore (të moshuar, dado, brezi i ri, institucionet shtetërore etj.), kurset pér edukatorët dhe demonstruesit e rinj të licencuar të ndihmës së parë kurse rifreskimi të ndihmës së parë pér edukatorë dhe demonstrues tanimë të licencuar të ndihmës së parë, kurse pér makijazhistë dhe manekinë pér paraqitjen realiste të lëndimeve, kurse pér gjyqtarë të licencuar pér garat komunale dhe shtetërore të ndihmës së parë, trajnime pér personat jo mjekësorë pér të përdorur një defibrilator automatik të jashtëm, pjesëmarrje në ushtrimet e simulimit duke paraqitur në mënyrë realiste lëndimet në bashkëpunim me institucione tjetra qeveritare, implementimi i projekteve nga fusha e ndihmës së parë, monitorimi i risive në ndihmën e



parë në nivel ndërkombëtar dhe nacional, shënim i Ditës botërore të ndihmës së parë, shënim i Ditës botërore të viktimateve të aksidenteve të trafikut, si dhe bashkëpunimi ndërkombëtar me shoqatat tjera nationale të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe në fushën e ndihmës së parë.

Realizimi i këtyre aktiviteteve duhet të kontribuojë në rritjen e numrit të stafit të arsimuar pér realizimin e programeve mësimore të ndihmës së parë, rritjen e resurseve të kuadrove dhe materialeve gjatë realizimit të aktiviteteve të fushës së ndihmës së parë, aplikimi i përmbajtjeve të reja mësimore pér grupe të ndryshme qëllimore, aplikimi i modeleve të reja të organizimit të garave komunale dhe shtetërore të ndihmës së parë, ngritja e ndërgjegjes së popullsisë pér rëndësinë e marrjes së njojurive pér ndihmën e parë, rritja e numrit të vullnetarëve, sigurimi i ndihmës dhe shërbimeve më cilësore pér grupet qëllimore, rritja e kapacitetit të grupeve të cenesëshme pér ofrimin e ndihmës së parë dhe përforcimi i kontributit të partneritetit në implementimin e aktiviteteve të programit në fushën e ndihmës së parë.

Sigurimi i një edukimi cilësor dhe shkencor i ndihmës së parë në dispozicion për secilin do të kontribuojë në ndërtimin e komuniteteve të sigurta dhe të shëndetshme përmes parandalimit dhe reduktimit të rreziqeve në fatkeqësitë dhe katastrofat e përditshme. Trajnim i për ndihmën e parë është një mjet i vlefshëm pér ndërtimin e një kulture të vërtetë të parandalimit nga e cila do të ketë përfitime komuniteti i përgjithshëm.



## DHURO GJAK. DHURO TANI, DHURO SHPESH

Dhurimi vullnetar i gjakut në Republikën e Maqedonisë ka një qëllim të vetëm, dhe ky është të motivohen një numër sa më i madh njerëzish për të dhënë gjak në mënyrë që të mblidhen sasitë e nevojshme të gjakut dhe komponentët e gjakut që janë të domosdoshëm për shërimin e të sëmurëve dhe të lënduarve. Dhurimi i gjakut i zhvillon veçoritë e humanizmit dhe solidaritetit dhe ka rëndësi edukative tek qytetarët, dhe sidomos tek të rinjtë, kontribuon në ngritjen e nivelit të kulturës shëndetësore dhe të ndërgjegjes publike. Për këto arsyе motivimi i popullsisë për të dhënë gjak në mënyrë vullnetare është jashtëzakonisht e rëndësishme për ndërtimin e një marrëdhënie pozitive ndaj dhurimit të gjakut.

Gjaku si ilaç akoma është i pazëvendësueshëm dhe marrja e tij varet ekskluzivisht nga vullneti i njerëzve dhurues të gjakut, të cilët në mënyrë vullnetare, anonime, falas dhe në mënyrë solidare dhurojnë gjak. Gjaku dhe komponentët e gjakut që janë marrë nga dhurimi vullnetar i gjakut janë një qëllim i rëndësishëm nacional për të parandaluar mungesën e gjakut dhe për të përbushur nevojat transfuziologjike të pacientëve anembanë vendit. Pacientët duhet të kenë qasje të barabartë në gjakun, në bazë të nevojave të tyre klinike dhe spitalore, dhe siguria e pacientëve dhe dhuruesve të gjakut duhet të jetë në nivelin më të lartë.



## Promovimi i dhurimit vullnetar të gjakut.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë dhe Instituti i Mjekësisë së Transfuzionit promovojnë barabarësi, qasshmëri, cilësi dhe siguri të gjakut dhe komponentët e gjakut me qëllim qytetarët të kenë besim në sigurinë dhe integritetin e sistemit të transfuziologjisë.

Programi për organizimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe Ligji për sigurinë në furnizimin me gjak, do të zbatohen përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm dhe të përhershëm me Institutin e Mjekësisë së Transfuzionit gjatë vitit, dhe pjesa më e madhe e aktiviteteve do të zbatohet nga një ekip i përbashkët i koordinimit i cili punon në planifikimin dhe organizimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, monitoron dhe koordinon të gjitha aksionet e dhurimit të gjakut të parashikuara me Planin vjetor integral për organizimin e aksioneve të dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, jep këshilla dhe rekomandime profesionale për organizatat komunale të Kryqit të kuq dhe shërbimet e mjekësisë së transfuzionit. Për një realizim të suksesshëm të Programit të dhurimit të gjakut gjithashtu është i rëndësishëm bashkëpunimi me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Republikës së Maqedonisë.

Për një promovim të suksesshëm të dhurimit vullnetar të gjakut, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në vazhdimësi përgatit materiale shëndetësore – edukative dhe propaganduese, mirënjoyje jubilare për dhuruesit e gjakut, zbaton anketa, organizon ligjëratë dhe tribuna dhe zbaton fushata me grupe të ndryshme qëllimore, organizon seminare dhe punëtori edukative për edukimin e motivuesve për dhurimin vullnetar të gjakut, zbaton aktivitete në përputhje me Strategjinë e dhurimit të gjakut dhe Politikën e dhurimit të gjakut të vitit 2013, informon popullsinë për aktivitetet përmes UEB faqeve të dyja institucioneve dhe E-gazetës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, mban evidencë elektronike dhe të shkruar për dhuruesit e gjakut dhe përgatit raporte mujore, periodike dhe vjetore.

**Aktivitetet e Klubeve të dhuruesve të gjakut dhe Klubet 25.** Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë vëmendje të madhe i kushton punës vullnetare të Klubeve të dhuruesve të gjakut me qëllim që të mobilizohen një numër sa më i madh i dhuruesve të gjakut të cilët rregullisht janë informuar për të gjitha aktivitetet dhe problemet me të cilat përballen në veprimtarinë e dhurimit të gjakut. Të popullarizuara janë aktivitetet e Klubeve 25 nga Shkupi, Manastiri dhe Ohri i të rinjve dhe i dhuruesve potencialë të gjakut me qëllim që të rritet numri i tyre, në mënyrën e duhur të rekrutohen dhe të mbahen në procesin e dhurimit të gjakut dhe të krijojnë një rrjet të të rinjve dhurues të gjakut për



kryerjen e promovimit dhe motivimit të dhuruesve të rinj të gjakut në institucionet arsimore.

**Mbështetja e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë respektivisht e Ministrisë së Shëndetësisë** mundësojnë implementimin e Programit vjetor për organizimin dhe avancimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë, qartë të përcaktohen roli, aktivitetet, detyrat dhe obligimet e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë dhe Institutit të Mjekësisë së Transfuzionit dhe të realizohen edukime për motivues të rinj për dhurim vullnetar të gjakut dhe të motivues të rinj.

Politika e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë për dhurimin e gjakut është në përputhje me qëllimet zhvillimore të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe dhe Organizatës Botërore Shëndetësore.

**Qendra ditore e dhurimit të gjakut.** Një hap para në procesin e përparimit të dhurimit të gjakut në territorin e qytetit të Shkupit është puna e Qendrës ditore për dhurimin e gjakut. Në një hapësirë me qëllim të përshtatur dhe pajisur në kuadër të ShOH "Dare Xhambaz", në një mëdisë të bukur dhe të ngrrohtë dhuruesit e gjakut kanë mundësinë për të treguar humanizmin e tyre përmes aktit të dhurimit të gjakut çdo ditë pune dhe të shtunën.

**Shënim i 17 marsit dhe 14 qershorit.** Në vitin 2019 me aktivitete të përshtatshme dhe të promovimit do të shënohen 17 marsi – Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë dhe 14 qershor – Dita botërore e dhurimit të gjakut.

Në vitin 2019 do të ndërmerren të gjitha masat dhe aktivitetet e nevojshme për organizimin e numrit të mjaftueshëm të aksioneve të regullta dhe tradicionale të dhurimit të gjakut me qëllim që në vazhdimësi të sigurohen sasitë e nevojshme të gjakut dhe të komponentëve të gjakut në dispozicion për të gjithë qytetarët për të cilët janë të domosdoshëm duke kontribuuar në këtë mënyrë për ndërtimin e komuniteteve të sigurta dhe të shëndetshme.

## "KONTRIBUTI PËR PËRMIRËSIMIN E CILËSISË SË JETËS SË POPULLSISË SË CENUESHME"

Kryqi i kuq i RM-së në kuadër të veprimitarë sociale-humanitare në vazhdimësi angazhohet dhe bën përpjekje në mbrojtjen e dinjitetit dhe përmirësimin e jetës së personave të ballafaquar me rreziqe të caktuara sociale. Kjo veprimi përfshin organizimin dhe sigurimin e ndihmës, kujdesit dhe shërbimeve psiko-sociale për popullsinë e cenesueshme. Me qëllim që të ofrohen shërbime më cilësore për përdoruesit finalë, Kryqi i kuq i RM-së në vazhdimësi zbaton aktivitete për përforcimin e kapaciteteve materiale dhe njerëzore. Parandalimi gjithashtu është një segment i rëndësishëm në veprimtarinë sociale-humanitare i cili realizohet me grupe konkrete qëllimore me qëllim të mbrojtjes dhe ballafaqimit me rreziqe të caktuara sociale.

Në implementimin e aktiviteteve, Kryqi i kuq i RM-së gjatë vitit 2019 do të realizojë bashkëpunim dhe mbështetje me institucione dhe ente relevante qeveritare, shoqata të qytetarëve, komunitetin e biznesit, si dhe përfshirjen e popullsisë së komuniteteve të cenesueshme. Me aktivitetet e programit do të përfshihen grupe të ndryshme qëllimore siç janë qytetarët e moshuar, personat me aftësi të kufizuara, rastet sociale, komunitetet e cenesueshme, popullsia e re, si dhe popullsia e përgjithshme në fushata të gjera për ngritjen e ndërgjegjes publike për përfshirje dhe mbështetje të aktiviteteve humanitare të Kryqit të kuq.



### **Java e solidaritetit dhe Dita e urisë.**

Me qëllim që të rritet kapaciteti i shoqatës nationale për t'u përgjigjur sfidave për përbushjen e nevojave të caktuara të grupeve të cenesueshme qëllimore në komunitetet, gjatë vitit do të organizohen dy aksione të mëdha humanitare në kuadër të shënimit të Javës së solidaritetit dhe Ditës së urisë. Në këto aksione do të sigurohet ndihmë në ushqim, veshmbathje, mjete të higjienës, si dhe donacione në para dedikuar për të ndihmuar personat e cenesueshmë për të cilët mbështetja e tillë është e domosdoshme.

### **Dita ndërkombëtare e të moshuarve dhe Java e kujdesit për të moshuarit.**

Qëllimi i shënimit të ditës dhe javës së kujdesit për të moshuarit është ngritja e ndërgjegjes së popullsisë për realizimin e të drejtave dhe ndihmës dhe kujdesit të nevojshëm për të moshuarit. Do të organizohen aktivitete edukative në tema me interes për personat e moshuar, aktivitete të rekreacionit dhe kreativitetit, si dhe aktivitete për mbështetjen e qytetarëve të moshuar në komunitetet.

## Dita evropiane e luftës kundër tregtisë me njerëz dhe Java e luftës kundër tregtisë me njerëz.

Kryqi i kuq i RM-së si anëtar i Sekretariatit të Komisionit nacional për luftë kundër tregtisë me njerëz dhe migrim ilegal jep kontribut aktiv në luftën kundër tregtisë me njerëz që përfaqëson një problem global që reflektohet edhe në vendin tonë. Gjatë këti viti Kryqi i kuq i RM-së do të përfshihet në shënimin e Dites Evropiane dhe Javës së luftës kundër tregtisë me njerëz, në kuadër të së cilave do të organizohen punëtori parandaluese edukative, si dhe ngjarje publike.



### Kujdesi dhe mbështetja për të moshuarit.

Aktivitetet e lidhura me plakjen që realizohen në Kryqin e kuq të Republikës së Maqedonisë janë pjesë të planeve zhvillimore përparrimin e përfshirjes sociale dhe përmirësimit të cilësisë së jetës së popullsisë së cenesueshme. Në këtë drejtim Kryqi i kuq i RM-së edhe në vitin 2019 në vazhdimësi do të vazhdojë të zbatojë dhe zhvillojë aktivitetet përkujdesin dhe mbështetjen e të moshuarve. Mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë, Kryqi i kuq i Zvicrës, institucionet qeveritare, si dhe partnerët e sektorit të korporatave në vazhdimësi do të vazhdojë me zbatimin e aktiviteteve të projektit përkujdes ndaj personave të moshuar në shtëpi. Përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse nga ana e vullnetarëve të Kryqit të

kuq dhe infermierave të angazhuara përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq, do të sigurohet mbështetje përpërbushjen e nevojave parësore të personave moshuar të vetmuar dhe të pafuqishëm në shtëpi të cilët përballen me rreziqe të caktuara sociale. Qendrat ditore për të moshuarit që funksionojnë përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe Organizata komunale e Kryqit të kuq të Gazi Babës, si dhe klubet e të moshuarve që funksionojnë përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq të Kriva Pallankës, Negotinës, Velesit dhe Prilepit janë forma të organizuara përmes mbështetjen e të moshuarave dhe ato gjatë vitit do të zhvillohen në bashkëpunim dhe mbështetje të institucioneve qeveritare dhe sektorit të korporatave.

Kryqi i kuq i RM-së është organizatë e verifikuar që zbaton trajnime përkujdestarë/e përtë personat e moshuar dhe të pafuqishëm. Trajnimet në përputhje me kandidatët e interesuar do të zbatohen edhe gjatë vitit 2019. Në bazë të mbështetjes së siguruar të projektit, Kryqi i kuq i RM-së do të zbatojë trajnime falas përgrupet e cenesueshme të popullsisë, të cilët do të aftësohen profesionalisht përtë ofruar shërbime cilësore përtë moshuarit në shtëpi, dhe në këtë mënyrë do të bëhen më konkurrentë në tregun e punës.

Iniciativa e Kryqit të kuq të RM-së dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit është që në vitin 2019 të fillojë projektin pilot – thirrje përtë intervenuar në mënyrë emergjente përtë moshuarit, përmes vendosjes së një qendre monitorimi 24/7, tek 60 të moshuar të cilët jetojnë vetë në territorin e qytetit të Shkupit.



## Bashkëpunimi rajonal për përfshirje sociale të personave të moshuar.

Vitin e tretë në vazhdimësi është duke u bërë implementimi i projektit rajonal "Ndërmarrja e aktiviteteve për përfshirje sociale të personave të moshuar", i financuar nga Bashkimi Evropian, mbështetur nga Kryqi i kuq i Austrisë dhe Agjencija Austriake e Zhvillimit. Deri në fund të janarit të vitit 2019 do të rrumbullakohet projekti përmes Kryqit të kuq të Serbisë, Kryqit të kuq të Maqedonisë dhe Shoqatës qytetare "Humanost" nga Maqedonia, Kryqit të kuq të Malit të Zi dhe shoqatat qytetare të Shqipërisë dhe Bosnjës e Hercegovinës. Qëllimi i projektit është që rrjetat e formuara rjonale të shoqatave qytetare dhe organizatat e Kryqit të kuq në pesë vendet e Ballkanit Perëndimor të bëjnë implementimin e aktiviteteve me qëllim që të rritet ndërgjegjja publike dhe ndikimet pasuese në proceset e vendimmarrjes për përfshirje sociale të personave të moshuar. Në Maqedoni aktivitetet janë duke u zbatuar përmes nëntë anëtarëve të rrjetit – InkluzivaM e formuar në kuadër të projektit. Gjatë vitit do të vazhdojë koordinimi i anëtarëve dhe do të bëhen përpjekje për të siguruar mbështetje për implementimin e aktiviteteve në përputhje me Planin e miratuar strategjik të rrjetit për përfshirje sociale të personave të moshuar.



### Asistencë personale për personat me aftësi të kufizuar

Me iniciativën e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë është përfshirë në zhvillimin e programit të asistencës personale për personat me aftësi të kufizuar. Programi i asistencës personale për personat me aftësi të kufizuar ka për qëllim të kontribuojë për një jetesë të pavarur të personave me aftësi të kufizuar dhe pjesëmarrjen e tyre aktive dhe të barabartë në komunitet dhe në shoqërinë në përgjithësi. Asistencë personale për personat me aftësi të kufizuar



është një shërbim i mbrojtjes sociale, përmes së cilës sigurohet mbështetje për personin me aftësi të kufizuar për pavarësimin e tij dhe një jetë të pavarur, në përputhje me nevojat individuale të përdoruesit.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Shoqatën "Humanost" përgatiti një program të trajnimit për asistentë personalë për personat me aftësi të kufizuar i cili është verifikuar nga ana e Qendrës së arsimit për të rriturit. Gjithashtu është verifikuar organizata e Kryqit të kuq të RM-së për të kryer trajnime në Shkup, Manastir, Strugë, Strumicë, Gostivar, Negotinë dhe Kumanovë. Gjithsej 52 asistentë janë angazhuar për ofrimin e shërbimeve përkatëse për përdoruesit. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale edhe gjatë vitit 2019 do të vazhdojë zhvillimin e këtij programi edhe në komunat tjera në përputhje me nevojat e përdoruesve.



### Zhvillimi i përbashkët komuniteteve.

Projekti "Zhvillimi i përbashkët i komunitetit" në periudhën e deritashme është aplikuar në mbi 24 organizata komunale të Kryqit të kuq dhe Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit. Mbështetur nga Federata Ndërkombëtare gjatë vitit 2019 do të vazhdojë të zhvillohet përmes dy organizatave komunale në komunitete të cenueshme në të cilat jeton popullsi rome. Në bazë të vlerësimit të bëre për nevojat dhe priorititetet e verifikuara në komunitet do të bëhet

implementimi i mikro-projekteve me qëllim që të nxitet zhvillimi i përbashkët i komuniteteve. Do të formohen dy ekipe me përfaqësues të Kryqit të kuq, institucionet dhe entet qeveritare, shoqatat e qytetarëve, si dhe përfaqësues të komuniteteve të ceneshe. Zhvillimi i përbashkët i komunitetit përfaqëson një mjet përmes së cilit mundësohet përfshirja direkt e personave të ceneshe për të ndikuar në vendimmarrje për përmirësimin e cilësisë së jetës së komuniteteve.

### **Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjeve me aftësi të kufizuara dhe mbështetja psiko-sociale e fëmijëve në familjet kujdestare.**

Përmirësimi i socializimit të fëmijëve dhe të rinjeve me aftësi të kufizuara është një aktivitet i vazhdueshëm, implementimin e të cilët Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë e bën në bashkëpunim me Entin për veprimtari sociale përmes Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit dhe organizatat komunale të Kryqit të kuq të Velenicës, Prilepit, Kavadarit, Dellçevës, Dibrës, Kërçovës dhe Gostivarit. Tetë vjet në vazhdimësi këto aktivitete të projektit janë mbështetur nga Banka Komerciale dhe implementimi i tyre është bërë në bashkëpunim me qendrat ditore përfëmijët me aftësi të kufizuara. Me aktivitetet e projektit sigurohet edhe mbështetja psiko-sociale përfëmijët në familjet kujdestare në Shkup, Velenicë, Prilep. Për të siguruar një qasje më të mirë dhe përtë marrë shkathësitë dhe njojuritë adekuate përtë mbështetur fëmijët me aftësi të kufizuara, do të organizohen punëtori edukative përforçimin e kapaciteteve të vullnetarëve të Kryqit të kuq.

Implementimi i aktiviteteve përfërmirësimin e socializimit të fëmijëve dhe të rinjeve me aftësi të kufizuara do të bëhet përpjekje përtë vazhduar me mbështetjen edhe të kompanisë "Makprogres" nga Vinica, si dhe të zhvillohen dhe të zgjerohen me partnerë të tjera të vendit.



### **Lufta kundër tregtisë me njerëz.**

Gjatë këtij viti me mbështetjen e Federatës ndërkombëtare përmes organizatave komunale të Kryqit të kuq do të bëhet implementimi i aktiviteteve preventive përförçimin e bashkëmoshatarëve të vullnetarëve të organizatave komunale të Kryqit të kuq të cilat në mesin e tyre do të transferojnë njojuritë përförçimin e bashkëmoshatarët e tyre përmes leksioneve të organizuara edukative preventive në shkollat fillore dhe të mesme. Aktivitetet preventive janë orientuar drejt ngritjes së ndërgjegjes së popullsisë së re përtë njojuritë mënyrat përmes së cilave të rinjtë mund të jenë tërhequr në tregtinë me njerëz dhe vetëmbrojta e tyre.



Aktivitetet/projektet e programit	Indikatorët
<b>Qendra ditore për të moshuarit dhe qendra për ofrimin e ndihmës në shtëpi – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Vizita të personave të moshuar në shtëpi nga ana e infermiereve dhe vullnetarëve</li> <li>distribucioni i barnave</li> <li>aktivitetet në qendrat ditore për të moshuarit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>180 të moshuar janë vizituar në shtëpi</li> <li>1000 vizita të realizuara nga ana e infermiereve</li> <li>1500 orë vullnetare të kaluara për nevojat e të moshuarve</li> <li>900 barna janë distribuuar në bazë mujore</li> <li>1000 vizita në qendrat ditore</li> <li>650 të moshuar janë regjistruar në evidencën e vizitorëve të qendrës ditore</li> <li>200 ligjérata dhe aktivitete të realizuara për të moshuarit</li> </ul>
<b>Qendra për mbështetjen e të moshuarve me shikim të dëmtuar - Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>aktivitete mujore në Qendrën</li> <li>Mbështetja grupore për prindërit e fëmijëve me shikim të dëmtuar</li> <li>Punëtori të ndërtimit të ekipeve</li> <li>Punëtori për lobimin dhe përmirësimin e të drejtave të personave me shikim të dëmtuar</li> <li>Aktivitete për rekrutimin e përdoruesve në vullnetarë</li> <li>Trajnime për të vepruar në mënyrën e duhur me personat me shikim të dëmtuar</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>218 ligjérata/kurse/punëtori me personat me shikim të dëmtuar</li> <li>9 punëtori, 8 përdorues</li> <li>6 punëtori, 10 punonjës</li> <li>3 punëtori, 150 përdorues</li> <li>10 punëtori të motivimit</li> <li>4 trajnime, 80 vullnetarë</li> </ul>
<b>Ndërmarrja sociale “Kopçe” – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Shitja e veshjeve të dorës së dytë për qytetarët</li> <li>Distribucioni falas i veshjeve për personat në rrezik social</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë shërbyer mbi 6000 blerës dhe është rritur pikë e rentabilitetit të “Kopçe”-s</li> <li>Janë shërbyer mbi 200 familje në rrezik social me mbi 5 000 pjesë të veshjeve</li> </ul>
<b>Ndërmarrja sociale “Nega Centar” – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>trajnimi për kujdestarë të personave të moshuar dhe të pafuqishëm</li> <li>ofrimi i shërbimeve për kujdes të personave të moshuar në shtëpi</li> <li>trajnimi për Plakjen e shëndetshme</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Janë trajnuar dhe certifikuar 15 kujdestare për personat e moshuar dhe të pafuqishëm</li> <li>Janë shërbyer mbi 90 persona të moshuar dhe të pafuqishëm</li> <li>Janë angazhuar mbi 20 kujdestare në terren dhe është përparuar vetë-qëndrueshmëria e Ndërmarrjes sociale “Nega Centar”</li> <li>Janë trajnuar 80 vullnetarë, infermieri dhe kujdestare</li> </ul>
<b>Qendra për të pastrehët e Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>Janë realizuar shërbime mjekësore-këshilluese si dhe intervenime dhe hetime të rregullta spitalore</li> <li>mirëmbajtja e higjienës personale</li> <li>mbështetja psiko-sociale për të pastrehët</li> <li>Përmirësimi dhe përforcimi i kohezionit familial</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Për 55 persona të pastrehë janë ndarë gjithsej</li> <li>2000 barna, 15.000 pjesë të veshjeve</li> <li>60 asistenca nga ana e punonjësit social për institucionet e karakterit shëndetësor dhe social</li> <li>650 vizita për të pastrehët gjatë temperaturave ekstreme të ulëta në pjesën e stacionarit</li> <li>100 biseda konsultative – këshillimore psikologjike</li> </ul>

# GATISHMËRIA DHE VEPRIMI GJATË KATASTROFAVE

Gjatë vitit 2019 aktivitetet në planin e gatishmërisë dhe veprimit gjatë katastrofave do të orientohen në implementimin e Politikave të caktuara të menaxhimit të katastrofave të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, si dhe në qëllimet e Agjendës globale të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së këqe.

## Përgjigjja në kohë dhe efikase në rast të fatkeqësive dhe katastrofave në nivel lokal.

Drejtimet nismëtare dhe aktivitetet parësore të qëllimeve të planit për gatishmëri dhe veprim gjatë katastrofave në vitin 2019, do të orientohen drejt politikave për gatishmëri, veprim dhe këndellje në rast të katastrofave në nivel lokal. Do të iniciohen një sërë aktivitetesh dhe iniciativash për të përforçuar organizatat komunale të Kryqi të kuq kapacitetet e tyre, dhe në këtë mënyrë edhe mundësitet për një përgjigje në kohë e duhur dhe efikase për nevojat e popullsisë lokale në rast të një fatkeqësie ose katastrofe. Vullnetarët tanë dhe personat e punësuar në mënyrë profesionale është e nevojshme për të arritur shkallën e edukimit të planit për gatishmëri dhe veprim në rast të katastrofave, dhe në këtë mënyrë njojuritë dhe përvojat e tyre do t'i transmetojnë në popullsinë lokale për të zbutur shkallën e dëmtimeve dhe humbjen e jetëve njerëzore. Për këtë qëllim do të bëhen përpjekje të konsiderueshme për të trajnuar ekipet komunale për përgjigje ndaj katastrofave. Përveç trajnimit, theks i veçantë do të vihet në bashkëpunimin dhe koordinimin midis ekipave të organizatave të ndryshme komunale për të përmirësuar operativitetin e tyre, kështu që në të ardhmen do të mundësohej një qasje shumë më efikase drejt përbushjes së nevojave të popullsisë

së ceneshmë përmes bashkëpunimit të përforçuar dhe aksionit të koordinuar.

## Platforma nationale për uljen e rreziqeve nga fatkeqësítë dhe katastrofat

Kyq i kuq i Republikës së Maqedonisë do të kujdeset për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me të gjitha subjektet të cilat janë përcaktuar me Platformën nationale të RM-së për uljen e rreziqeve nga fatkeqësítë dhe katastrofat, sidomos për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me Qendrën e menaxhimit të krisave dhe Drejtorinë e mbrojtjes dhe shpëtimit.

Gjatë vitit 2019, do të fillojë diseminimi i Procedurave standarde operative për reagim në rast të katastrofave të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, duke e aplikuar në mënyrë praktike në nivel lokal në rast të katastrofave.

**Në planin ndërkombëtar**, në bashkëpunim me Kryqin e kuq të qytetit të Shtajerit, në vitin 2019 është parashikuar të mbahet një trajnim për Ujë dhe sanitet dhe promovimi i higjienës, i cili do të dedikohet përfreshimin e njojurive dhe shkathtësive të vullnetarëve tanimë të trajnuar, si dhe për zbatimin e një trajnimi fillestare për vullnetarët e rinj. Është planifikuar një ushtrim final i simulimit në të cilin do të vlerësohet niveli i njojurive të marra të pjesëmarrësve në këtë trajnim.



**Në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit** me qëllim të ngritjes së ndërgjegjes në sistemin arsimor, do të vazhdojnë aktivitetet për ngritjen e ndërgjegjes publike tek institucionet/çerdhet arsimore. Edhe në vitin 2019, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë do të punojë në Projektin ndërkombëtar "Shkolla dhe çerdhe të sigurta", i mbështetur financiarisht nga "Erazmus", në të cilin janë përfshirë Kryqi i kuq i Austrisë, Kryqi i kuq i Serbisë, Bullgarisë dhe Hungarisë. Ky projekt përfshin aktivitete për përforcimin e ndërgjegjes në institucionet arsimore, në mesin e nxënësve dhe punonjësve (arsimtarët dhe stafi teknik). Implementimi i aktiviteteve është bërë në nivel lokal, në bashkëpunim me faktorë të tjera që janë pjesë e Sistemit për menaxhimin e krizave në nivel lokal.



**Siguria në ujë.** Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pjesën e sigurisë në ujë, aktivitetet e veta në vitin 2019 do t'i orientojë drejt përforcimit të kapaciteteve të Qendrave të sigurisë në ujë në Ohër dhe Shkup, me prioritete në planifikimin dhe zbatimin e aktiviteteve në pjesën e shpëtimit në ujë, trajnim për shpëtimtarë, edukim, arsimim dhe përsosje profesionale për shpëtimin në ujë, kontrollim të aftësive psikofizike dhe funksionale të shpëtimtarëve në ujë, punë profesionale-këshillimore dhe profesionale-informative, planifikim i programeve dhe projekteve për verifikim të qëndrimeve doktrinare në edukimin e shpëtimtarëve në ujë, dokumentim të literaturës profesionale, planifikim dhe organizim të fushatave dhe aksioneve të promovimit, marrëdhëniet me publikun dhe kontakti me mjetet e informimit publik në pjesën e sigurisë në ujë. Lidhur me aplikimin e softuerit janë planifikuar shumë trajnime shtesë për përdorimin e softuerit të shpëtimtarëve për koordinues të rinj të sigurisë në ujë nga Shkupi, Ohri, Struga dhe Velesi. Në plan është rishikimi i rregullorëve ekzistuese të sigurisë në ujë dhe plotësimi i tyre.

**Siguria në mal.** Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në pjesën e sigurisë në mal, aktivitetet do t'i orientojë drejt përforcimit të kapaciteteve të Shërbimeve për shpëtimin në mal në rajonin e Shkupit dhe Ohrit. Ekipi i shpëtimit në mal i Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, mbështetur financiarisht nga qyteti i Shkupit do të angazhohet në mbulimin e sigurt të vendeve të piknikut në malin Vodno dhe kanjonin Matkë gjatë vikendeve. Në planin e sigurisë në mal, Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Or-

ganizata komunale e Ohrit është bartës i projektit të programeve IPA për bashkëpunim përtej kufijve të EU "Liqeni i Ohrit – destinacion i sigurt për turizëm aventuresk".

**Migruesit dhe refugjatët.** Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë – Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit do të vazhdojë asistencën mjekësore dhe humanitare për migruesit dhe refugjatët të cilët janë akomoduar përkohësisht në Qendrat e transitit për refugjatë/migrues në Tabanoc (Kumanovë) dhe Vinojug (Gjevgjeli), me migruesit e parregullt në Llojan dhe Vaksincë dhe Qendrën e pranimit për të huajt – Gazi Babë. Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit do të vazhdojë mbulimin 24 orësh në qendrat Vinojug, Tabanoc dhe Llojan/Vaksincë me ekipet e ndihmës së parë, mbështetjen logjistike, ekipin e distribucionit si dhe ekipin e shërbimit për kërkesa. Ekipi mobil Likova pranë Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit në bashkëpunim me donatorët dhe partnerët, në vitin 2019 do të vazhdojë implementimin e projektit të asistencës humanitare për migruesit e parregullt përgjatë brezit të gjelbër të kufirit verior të Republikës së Maqedonisë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme në Qendrën e pranimit për të huajt – Gazi Babë, Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit do të vazhdojë të sigurojë mbrojtjen primare shëndetësore, tirazhin e migruesve në këtë qendër dhe ndërmjetësimin në nivel sekondar dhe terciar. Do të sigurohen barnat e nevojshme në bazë javore dhe ndihma humanitare në produktet ushqimore dhe jo ushqimore.

## RIVENDOSJA E LIDHJEVE FAMILJARE

Komponentët e ndryshëm të Lëvizjes së Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe me dekada bëjnë përpjekje të jashtëzakonshme për të rivendosur lidhjet familjare. Ky shërbim unik përfaqëson thelbin e punës së Lëvizjes. Duke potencuar përvojën dhe vazhdimësinë e aktiviteteve të Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare të Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, është e pranishme ndërgjegjja dhe vullneti për një qasje të mëtejshme strategjike, zhvillimin e kapaciteteve të veta dhe të marrëdhënieve me partnerët.

Nga gjithë kjo buron edhe nevoja për një ngritje të përhershme të kapaciteteve në të gjitha nivelet e veprimit të Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare, për të arritur një përgjigje efektive dhe të mjaftueshme për nevojat humanitare të popullsisë në këtë plan.

Aktivitetet e Shërbimit për kërkesa të Kryqit të kuq të RM-së, janë orientuar drejt zgjidhjes së rasteve për rivendosjen e lidhjeve familjare lidhur me krizën e migruesve që është aktuale viteve të fundit. Për këtë qëllim është e nevojshme të mundësohet mbështetja logistike e ekipeve të Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare në terren.

Prania e takimeve ndërkombëtare të Shërbimit për kërkesa, për shkak të monitorimit dhe përparimit të programeve për rivendosjen e lidhjeve familjare në kuadër të shoqatave nacionale; Aktivitetet e mëtejshme për ndërtimin e një marrëdhënie adekuate me Qeverinë dhe institucionet qeveritare dhe organizatat partnere në terren, për shkak të realizimit më të suksesshëm të aktiviteteve të Shërbimit për kërkesa – Rivendosja e lidhjeve familjare.



# "PËRMES PËRGJEGJËSISË SHOQËRORE PËR INVESTIM TË PËRBASHKËT NË KOMUNITETET"

Sigurimi i mbështetjes nga sektori i korporatave është një nga segmentet e rëndësishme për implementim të suksesshëm të iniciativave shoqërore në interes të grupeve të ndryshme qëllimore në komunitetet. Në këtë drejtim me rëndësi është të vendosen partneritete afatgjata strategjike me kompani të fuqishme të cilat mund të jepin kontribut të përbashkët në uljen e ceneshmërisë së popullsisë. Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë gjatë viti 2019 do të vazhdojë bashkëpunimin me sektorin e korporatave dhe do të bëjë përpjekje për të përforcuar dhe zhvilluar atë me një numër sa më të madh partnerësh për mbështetjen e iniciativave të projektit me interes shoqëror.

## **Përforcimi dhe vendosja e bashkëpunimit të partneritetit me sektorin e korporatave.**

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në veprimin e tij realizon një bashkëpunim dhe partneritet të frytshëm me shumë kompani të vendit në nivel nacional dhe lokal të cilat si kompani të përgjegjshme shoqërore tregojnë interesim dhe gatishmëri për bashkëpunim dhe mbështetje në zbatimin e qëllimeve humanitare të Kryqit të kuq. Gjatë vitit 2019 do të organizohen takime me kompani për të siguruar mbështetje në implementimin e iniciativave të përbashkëta, aktivitete të projektit dhe të programit.

## **Bashkëpunimi me odat ekonomike në Maqedoni.**

Në vitin 2019 do të vazhdojmë të realizojmë dhe zhvillojmë bashkëpunimin me Odën Ekonomike të RM-së, Lidhjen e odave ekonomike të RM-së, Odën ekonomike të Maqedonisë veriperëndimore, Odën ekonomike amerikane, si dhe Odën e zejtariëve të

- RM0-së, me qëllim të implementimit të iniciativave të përbashkëta të përcaktuara në memorandumet e nënshkruara për bashkëpunim në drejtim të promovimit të përgjegjësisë korporative shoqërore të kompanive për mbështetjen e tyre në realizimin e programeve dedikuar për grupet e ceneshmë qëllimore të popullsisë.

## **Takimi i partneritetit.**

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë gjatë këtij viti do të organizojë një takim të partneritetit me përfaqësues të institucioneve qeveritare, agjencitë dhe organizatat ndërkombëtare dhe sektorin e korporatave. Qëllimi i takimit është të inkurajohet bashkëpunimi midis Kryqit të kuq dhe organizatave partnere, për të vendosur partneritete të qëndrueshme dhe për të siguruar mbështetje të projektit për programet shoqërore sociale përmirësimin e cilësisë së jetës së kategorive të ceneshmës në komunitetet.

## **Dhënia e mirënjojjeve të Kryqit të kuq për bashkëpunimin dhe mbështetjen e partneritetit.**

Në shenjë falënderimi për bashkëpunimin dhe mbështetjen në realizimin e qëllimeve humanitare të Kryqit të kuq për partnerët e tij të sektorit të korporatave do të japë mirënjojje përkatëse për kompanitë që praktikojnë punën e përgjegjshme shoqërore si pjesë përbërëse të politikës afariste. Për këtë qëllim do të organizohet një ngjarje e rastit për t'i dhënë rëndësi bashkëpunimit të vendosur të partneritetit dhe për të motivuar kompanitë për të mbështetje të mëtejshme të Kryqit të kuq në implementimin e projekteve dhe aktiviteteve programore.



## MONITORIMI DHE EVALVIMI

Duke pasur parasysh spektrin e gjerë të veprimit të organizatës së Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, në vitin 2019 është parashikuar investimi i përpjekjeve për sistematizimin dhe përmirësimin e cilësisë së procesit të monitorimit dhe evalvimit.

Në kuadër të procesit të mbledhjes dhe analizimit të informacioneve për të përcaktuar sa mirë janë duke u zbatuar politikat dhe programet e Kryqit të kuq, si dhe për të vlerësuar arritjen e qëllimeve dhe rezultateve, ose nga ana tjetër për të nxjerrë leksione të mësuara për punën e ardhshme, do të aplikohet një sistem i kontrollit dhe përpunimit të të dhënave.

Duke shfrytëzuar mjetet ekzistuese përmes zgjidhjes së autorizuar të softuerit dhe praktikat e informimit në kuadër të aktiviteteve të projekti dhe ato tradicionale të Kryqit të kuq, Zyra qendrore do të mund të verifikojë standardet dhe kriteret të cilat nga njëra anë do të jenë udhërrëfyes për planifikimin dhe implementimin e aktiviteteve në nivel lokal, dhe nga ana tjetër ato do të jenë të harmonizuara me nevojat dhe mundësitë aktuale për të vepruar në nivel lokal. Qasja e tillë mundeson që partnerët dhe donatorët të jenë në rrjedhë deri në ç'masë janë duke u përbushur qëllimet, do të përforcohet ndjeshëm transparenca dhe llogaridhënia, mundësohen marrja e vendimeve të duhura dhe njëkohësisht ndërtohet baza për planifikim dhe përgatitje më të mirë të programeve të ardhshme, duke pasur parasysh leksionet e mësuara dhe përvojat nga e kaluara.



## PUNA FINANCIARE MATERIALE

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë në buxhetin e tij qartë i prezanton të ardhurat dhe shpenzimet vjetore, të cilat mundësojnë konstruktimin e mënyrën së financimit të organizatës dhe mundësinë për të zbatuar një aktivitet, strategji dhe plan të caktuar.

Buxheti i përgjithshëm për vitin 2019 është ulur për 30,86 % në krahasim me Buxhetin e viti të kaluar. Ulja i referohet uljes së të ardhurave nga projektet e siguruara për mbështetjen e migruesve që kalojnë transit nëpër vendin tonë. Nga të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat e planifikuara të vetat sivjet marrin pjesë me 33,12% dhe janë rritur në raport me vitin e kaluar, ndërsa në shumë nominale janë përafërsisht të njëjtë, dhe të ardhurat nga organet dhe donatorët marrin pjesë me 66,88% dhe shënojnë ulje në raport me vitin e kaluar kur ato merrnin pjesë me 79,02%. Të ardhurat nga donatorët shënojnë rënje në shumë nominale si rezultat i mbështetjes së ulur të projektit të migruesve të cilët lëvizin në vendin tonë.

Në pjesën e shpenzimeve, shpenzimet kapitale marrin pjesë me 2,68%, shpenzimet aktuale janë 88,67% dhe shpenzimet për donacione dhe ndihmë janë 8,66% të shpenzimeve të përgjithshme. Edhe sivjet politika e organizatës është orientuar drejt zhvillimit të organizatave komunale të Kryqit të kuq për çka janë parashikuar mjete të caktuara për mbështetjen e zhvillimit dhe punës aktuale të OKKK-ve të rritura në raport me vitin e kaluar, të cilat paraprakisht do të përzgjidhen në bazë të kritereve të caktuara. Nga shpenzimet e përgjithshme në Buxhetin për vitin 2019, 28,82% kanë të bëjnë me shpenzimet për Centralin e KKRM-së, ndërsa 71,18% të Buxhetit të përgjithshëm janë dedikuar për organizatat komunale të KK dhe KK të qytetit të Shkupit. Gjithashtu me rëndësi është të përmendet se nga shpenzimet e përgjithshme të Centralit, 37,19% janë transfere direkt në OKKK për realizimin e aktiviteteve të programit dhe në shumën nominale janë përafërsisht të njëjtë në raport me vitin e kaluar.

Si shpenzime në Centralin e KKRM janë përfshirë shpenzimet përrrogat e punonjësve, shpenzimet materiale, si dhe shpenzimet përmirësimi aktuale. Në pjesën e shpenzimeve dedikuar për OKKK-të janë përfshirë shpenzimet për projektet nga donatorët ose për programet e siguruara nga institucionet.

Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë përmes monitorimit të trendëve modernë përmes modernizimin dhe përsosjen e punës materiale-financiare, mundëson transparencë dhe llogaridhënie të punës, përpunim automatik të të dhënavëve, rrjedhje të shpejtë të informacionit dhe tregues financiarë, bazë të saktë dhe gjithëpërfshirëse të të dhënavë financiare dhe rritje të kapaciteteve të shoqatës nationale në përgjithësi.

Buxheti i KKRM-së është real, gjithëpërfshirës, i strukturuar, preciz dhe i balancuar, dhe mjetet e planifikuar anë Buxhetin për vitin 2019, KKRM-ja do t'i përdor me qëllim, në mënyrë racionale dhe ekonomike, me transparencë dhe llogaridhënie të plotë.



# BUXHETI I KRYQIT TË KUQ TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË PËR VITIN 2019

	%	2019	2018	2017
Të ardhurat e përgjithshme	100.00	60,052,708.00	78,586,353.00	165,528,972.00
Burimet e veta	33.12	19,887,628.00	16,484,800.00	17,618,800.00
Nga organet dhe donatorët	66.88	40,165,080.00	62,101,553.00	147,910,172.00
<b>Shpenzimet e përgjithshme</b>	<b>100.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,353.00</b>	<b>165,528,972.00</b>
Shpenzimet aktuale	88.67	53,246,008.00	56,374,113.00	92,921,232.00
Shpenzimet kapitale	2.68	1,606,700.00	1,212,240.00	620,000.00
Ndihmat dhe donacionet	8.66	5,200,000.00	21,000,000.00	71,987,740.00
<b>Dallimi</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	

<b>TË ARDHURAT</b>					
PËRSHKRIMI	Burimet e veta të të ardhurave	Të ardhurat nga organet/ doantorët	Buxheti 2019"	Buxheti 2018	Buxheti 2018
<b>TRANSFERET DHE DONACIONET</b>					
Ministria e Punës dhe Politikës Sociale - aktivitetet e programit	6,000,000.00		6,000,000.00	6,000,000.00	6,000,000.00
Dhurimi i gjakut (Ministria e Shëndetësisë)		6,600,000.00	6,600,000.00	6,458,500.00	6,763,000.00
Veprimtaria sociale-humanitare	450,000.00	2,700,000.00	3,150,000.00	4,950,000.00	19,530,000.00
Organizimi dhe zhvillimi		11,960,000.00	11,960,000.00	31,072,000.00	7,096,000.00
Ndihma e parë	3,250,000.00		3,250,000.00	2,500,000.00	2,500,000.00
Edukimi shëndetësor		3,393,760.00	3,393,760.00	5,277,688.00	3,268,522.00
Rinia	336,000.00	530,000.00	866,000.00	336,000.00	420,000.00
Katastrofat		863,320.00	863,320.00	2,099,565.00	100,146,530.00
Diseminimi		197,600.00	197,600.00	756,120.00	756,120.00
KK në aksion - PVH		300,000.00	300,000.00	300,000.00	200,000.00
Informimi dhe komunikimi			0.00	448,000.00	0.00
Shërbimi për kërkesa		920,400.00	920,400.00	939,680.00	450,000.00
Bashkëpunimi ndërkombëtar			0.00	0.00	0.00
Mobilizimi i fondeve			0.00	0.00	0.00
			0.00	0.00	0.00
<b>TË ARDHURAT JO TATIMORE</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Nga OKKK (në bazë të kotizimit)	1,180,000.00		1,180,000.00	1,180,000.00	1,500,000.00
Donacionet nga personat fizikë	350,000.00		350,000.00	300,000.00	200,000.00
Donacionet nga personat juridikë	500,000.00		500,000.00	500,000.00	500,000.00
Markat me pagesë shtesë (nga Ligji i KK-së)	300,000.00		300,000.00	300,000.00	300,000.00
Nga dhënia me qira e hapësirës afariste	1,918,800.00		1,918,800.00	1,918,800.00	1,918,800.00
Nga regjistrimi i automjeteve	1,502,828.00	12,700,000.00	14,202,828.00	11,180,000.00	10,930,000.00
Nga kurset për shpëtimtarët në ujë	100,000.00		100,000.00	70,000.00	50,000.00
Mjete të transferuara nga viti i kaluar	4,000,000.00		4,000,000.00	2,000,000.00	3,000,000.00
<b>GJITHSEJ TË ARDHURA</b>	<b>19,887,628.00</b>	<b>40,165,080.00</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>78,586,353.00</b>	<b>165,528,972.00</b>

SHPENZIMET					
PËRSHKRIMI	Nga burimet e veta	Nga organet dhe donatorët	Buxheti 2019	Buxheti 2018	Buxet 2017
<b>SHPRENZIMET AKTUALE</b>					
<b>PAGAT BAZË DHE KOMPENSIMET</b>					
Paga bruto e punonjësve	10,452,716.00	1,620,248.00	12,072,964.00	10,294,416.00	10,294,416.00
Kompensimi për pushimin vjetor	0.00		0.00	0.00	0.00
Kompensime të tjera	40,000.00		40,000.00	40,000.00	40,000.00
<b>KONTRIBUITE NGA PAGAT DHE TATIMI PERSONAL</b>					
Tatimi personal nga kompensimet (mëditje, çmime jubilare)	30,000.00		30,000.00	30,000.00	30,000.00
<b>GJITHSEJ SHPRENZIMET PËR PAGAT</b>	<b>10,522,716.00</b>	<b>1,620,248.00</b>	<b>12,142,964.00</b>	<b>10,364,416.00</b>	<b>10,364,416.00</b>
<b>SHPRENZIMET RRUGORE DHE DITORE</b>					
Udhëtimet jashtë vendit	100,000.00		100,000.00	70,000.00	70,000.00
<b>SHËRBIMET KOMUNALE</b>					
Energjia elektrike	780,000.00		720,000.00	960,000.00	
Ujësjellësi dhe kanalizimi	60,000.00		50,000.00	50,000.00	
Mbeturinat	90,000.00		90,000.00	55,000.00	
<b>NGROHJA</b>					
Ngrohja qendrore	480,000.00		480,000.00	625,000.00	
<b>KOMUNIKIMI DHE TRANSPORTI</b>					
Posta	30,000.00		50,000.00	50,000.00	
Telefoni dhe telefaksi	720,000.00	31,200.00	1,393,320.00	1,476,525.00	
Mëditjet brenda dhe jashtë vendit	100,000.00		100,000.00	100,000.00	
Karburantet	420,000.00		590,000.00	2,590,392.00	
Shpenzimet për regjistrimin e automjeteve	435,000.00		360,000.00	170,000.00	
Shpenzime të tjera për transport (pagesat rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)	50,000.00		50,000.00	50,000.00	
<b>MATERIALET</b>					
Material i zyrës	120,000.00		106,750.00	1,326,346.00	
Parapagimi për revista dhe literaturë profesionale	41,000.00		41,000.00	41,000.00	
Shirita, kasetë dhe të tjera për AOP	100,000.00		50,000.00	50,000.00	
Kopjimi, shtypja dhe botimi i materialeve	449,000.00	1,227,100.00	2,917,685.00	3,553,660.00	
Organizimi dhe zhvillimi		0.00	660,320.00	660,320.00	
Informimi dhe komunikimi	99,000.00		380,800.00	0.00	
Diseminimi		0.00	0.00	0.00	
Veprimtaria shëndetësore - edukative		0.00	483,000.00	110,340.00	
Ndihma e parë	280,000.00		280,000.00	280,000.00	
Ndërkontëtare		0.00	0.00	0.00	
Dhurimi i gjakut	767,100.00		758,500.00	963,000.00	
Veprimtaria sociale - humanitare	200,000.00		300,000.00	200,000.00	
Shërbimi për kërkesa	260,000.00		0.00	0.00	
Mobilizimi i fondeve		0.00	0.00	0.00	
Qendra e trajnimit edukativ		0.00	0.00	0.00	
Katastrofat	20,000.00		55,065.00	1,340,000.00	
Të Rinjtë	50,000.00		0.00	0.00	
Pije, produkte ushqimore, mjete të higjienës	200,000.00		273,428.00	273,428.00	
Materiale për mbrojtjen kundër zjarrit	20,000.00		20,000.00	20,000.00	

Materialet me dedikim special (materialet mjekësore, materialet elektrike)	160,000.00	442,000.00	602,000.00	310,000.00	302,475.00
Drugi materijali	300,000.00		300,000.00	945,000.00	548,955.00
<b>MIRËMBAJTJA AKTUALE</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Rregullimi dhe mirëmbajtja e vetravave	250,000.00		250,000.00	200,000.00	200,000.00
Shpenzimet për mirëmbajtjen e pajisjeve	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
Shpenzimet për mirëmbajtjen e ndërtesës	200,000.00		200,000.00	350,000.00	350,000.00
Mirëmbajtja e softuerit dhe harduerit	516,000.00	175,500.00	691,500.00	312,000.00	312,000.00
<b>SHËRBIMET KONTRAKTUËSE</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Shërbimet e avokatit	120,000.00		120,000.00	159,780.00	159,780.00
Seminaret dhe takimet	3,197,000.00	4,089,670.00	7,286,670.00	11,393,210.00	20,629,516.00
Organizimi dhe zhvillimi	20,000.00	1,820,000.00	1,840,000.00	1,180,000.00	3,085,750.00
Informimi dhe komunikimi	65,000.00		65,000.00	80,000.00	90,000.00
Diseminimi	350,000.00		350,000.00	70,000.00	230,000.00
KKA - PVH	150,000.00		150,000.00	450,000.00	350,000.00
Veprimtaria shëndetësore - edukative	50,000.00		50,000.00	723,750.00	1,576,766.00
Ndihma e parë	410,000.00		410,000.00	1,866,000.00	1,796,000.00
Dhurimi i gjakut	120,000.00	332,900.00	452,900.00	320,000.00	420,000.00
Veprimtaria sociale - humanitare	50,000.00	900,000.00	950,000.00	3,505,000.00	11,601,000.00
Shërbimi për kërkesa	50,000.00	348,400.00	398,400.00	829,200.00	100,000.00
Mobilizimi i fondevës	10,000.00		10,000.00	10,000.00	10,000.00
Të Rinjtë	450,000.00	530,000.00	980,000.00	35,000.00	35,000.00
Katastrofat	120,000.00	158,370.00	278,370.00	1,222,260.00	100,000.00
Njësiti për reagim në katastrofa (trajnimi dhe aktiviteti)			0.00	0.00	0.00
Festimi shënnimi i 70-vjetorit të Kryqit të kuq të RM-së			0.00	0.00	0.00
Mbledhjet dhe puna e Këshillit udhëheqës	400,000.00		400,000.00	100,000.00	100,000.00
Kuvendi i KKRM-së	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
Takimi me sekretarët / kryetarët	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
Gara shtetërore e ndihmës së parë	350,000.00		350,000.00	400,000.00	400,000.00
Këshilli i të rinjve/Trupi koordinues	66,000.00		66,000.00	66,000.00	135,000.00
Kampi i të rinjve/Takimi koordinues evropian	336,000.00		336,000.00	336,000.00	400,000.00
Provizoni i Bankës	80,000.00		80,000.00	80,000.00	80,000.00
Sigurimi i pronës dhe sigurimi i objekteve	50,000.00		50,000.00	25,000.00	25,000.00
Shërbime të tjera financiare (kontrata për angazhime të kohë pas kohshme dhe të përkohshme)	141,012.00	2,745,202.00	2,886,214.00	3,856,524.00	22,226,999.00
Shërbime të tjera të kontraktuara (dogana, punëtorë për paketimin e ndihmës hum.), aktvendime gjyqësore, qiraja Revizioni i jashtëm	50,000.00		50,000.00	618,000.00	1,741,427.00
Pagesa e anëtarësimit në organiza ndërkombëtare	100,000.00		100,000.00	100,000.00	100,000.00
	150,000.00		150,000.00	150,000.00	150,000.00
<b>SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Sigurimi i fondevës	100,000.00		100,000.00	200,000.00	200,000.00
Shpenzimet për bashkëpunimin ndërkombëtar	200,000.00		200,000.00	200,000.00	970,000.00
<b>TRANSFERET PËR ORGANIZATAT JO PROFITABILE</b>			<b>0.00</b>	<b>0.00</b>	<b>0.00</b>
Transferet për OKKK-të	150,000.00	22,333,360.00	22,483,360.00	19,648,000.00	22,999,313.00
Fondi i zhvillimit			0.00	0.00	0.00
<b>SHPRENZIMET E PËRGJITHSHME AKTUALE</b>	20,581,728.00	32,664,280.00	53,246,008.00	56,374,113.00	92,921,232.00
<b>SHPENZIMET KAPITALE</b>					


<b>BLERJA E MOBILEVE DHE PAJISJE SË ZYRËS</b>				
Blerja e mobileve të zyrës		0.00	0.00	0.00
Blerja e pajisjeve (KKRM dhe EOK) dhe softuer, pajisje mjekësore		0.00	812,240.00	220,000.00
<b>BLERJA E AUTOMJETEVE</b>				
Blerja e automjetit (kredi për automjet)	600,000.00	600,000.00	0.00	0.00
<b>MIRËMBAJTA BAZIKE DHE SPECIALE</b>				
Investimet kapitale në OKKK	356,700.00	356,700.00	0.00	0.00
Mbështetja e zhvillimit të OKKK-ve	500,000.00	500,000.00	250,000.00	250,000.00
Rindërtimi dhe renovimi i objekteve të ndërtimit	150,000.00	150,000.00	150,000.00	150,000.00
<b>SHPENZIMET E PËRGJITHSHME KAPITALE</b>		1,606,700.00	0.00	1,212,240.00
<b>NDIHMAT, DONACIONET DHE PAGESAT E TJERA</b>				
Ndihmat, donacionet dhe pagesat tjera të subjekteve në natyrë		5,200,000.00	5,200,000.00	21,000,000.00
Ndihmat, donacionet dhe pagesat tjera të subjekteve në para			0.00	
<b>GJITHSEJ DONACIONET, NDIHMAT DHE PAGESAT TJERA</b>		0.00	5,200,000.00	21,000,000.00
<b>SHPENZIMET E PËRGJITHSHME</b>		22,188,428.00	37,864,280.00	78,586,353.00
				165,528,972.00

		%
Shpenzimet për Centralin e KKRM-së	17,305,728.00	28.82
Shpenzimet për OKKK-të	42,746,980.00	71.18
<b>GJITHSEJ</b>	<b>60,052,708.00</b>	<b>100</b>



Shërbimi  
Financiar  
Zhaklina Popoviq

Sekretari i  
përgjithshëm  
Dr. Sait Saiti


### TË ARDHURAT NË 2019



### SHPENZIMET NË 2019



### STRUKTURA E SHPENZIMEVE TË KKRM-së



# TABLE OF CONTENTS

CAN WE BE EVEN BETTER .....	71
160 ANNIVERSARY OF "THE BATTLE OF SOLFERINO" .....	72
100 ANNIVERSARY OF THE FOUNDATION OF THE INTERNATIONAL FEDERATION OF RED CROSS AND RED CRESCENT SOCIETIES .....	73
70 ANNIVERSARY FROM THE ADOPTION OF THE GENEVA CONVENTIONS .....	74
TOWARDS STRATEGY 2030 .....	75
ORGANIZATIONAL DEVELOPMENT .....	76
PROMOTION OF VOLUNTEERING IN MACEDONIAN RED CROSS .....	78
YOUTH OF MACEDONIAN RED CROSS .....	79
INTERNATIONAL PARTNERSHIP COOPERATION .....	80
COMMUNICATION AND ELEMENTS OF THE COMMUNICATION PROCESS .....	81
DISSEMINATION .....	83
INTERNATIONAL HUMANITARIAN LAW .....	83
RED CROSS IN ACTION - PROMOTION OF HUMAN VALUES (RCA-PHV) .....	84
HEALTH PREVENTIVE ACTIVITIES .....	85
FIRST AID AVAILABLE TO EVERYONE .....	86
DONATE BLOOD, DONATE NOW, DONATE OFTEN .....	87
"CONTRIBUTING FOR IMPROVEMENT OF THE QUALITY OF LIFE OF THE VULNER- ABLE POPULATION" .....	89
DISASTER PREPAREDNESS AND RESPONSE .....	94
RESTORING FAMILY LINKS .....	96
THROUGH SOCIAL RESPONSIBILITY FOR JOINT INVESTMENT IN THE COMMUNITIES .....	97
MONITORING AND EVALUATION .....	98
MATERIAL AND FINANCIAL OPERATION 2019 .....	99
MACEDONIAN RED CROSS BUDGET FOR 2019 .....	100



## CAN WE BE EVEN BETTER

